

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Diplomë
Profesionale: Turizëm¹”**

**i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Kreshnik Bello
2. Dr. Aurela Braholli
3. MSc. Bledi Selaj
4. Xhensila Damzi, studente

Shkurt/2021

¹ DPT - MENDIMI I DEKANIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË-FINAL (Ref.Nr.1)

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i studimit “Diplomë Profesionale: Turizëm” ofron kryesisht formim praktik, për arritjen e objektivave akademike dhe profesionale, me qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e Turizmit. Ky program është një vlerë e shtuar në ofertën akademike të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, dhe të Universitetit European të Tiranës, pasi specialistët e përgatitur në këtë fushë janë së tepërmi të kërkuar nga tregu i punës, duke qenë se sektori kontribuon në një masë mjaft të konsiderueshme në GDP e vendit tonë. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, që mbulon këtë program, vazhdimisht nxjerr në pah nevojën e tregut për formimin në nivelin operacional, të specialistëve për sipërmarrjet turistike, specialistëve në aplikimin e projekteve të lidhura me turizmin, specialistëve të sektorit publik dhe privat (në këtë fushë), etj, duke marrë në konsideratë pikërisht faktin e përmendur mesipër, që turizmi është shndërruar në një nga sektoret prioritarë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit tonë. Këtë zhvillim Departamenti e refleton në punën dhe në qasjen e tij kundrejt ecurisë së programit dhe përgatitjes së studentëve që e ndjekin atë. Programi u ofron studentëve njohuri të specializuara në fushën e turizmit, duke u siguruar atyre një mundësi për një edukim cilësor, përmes leksioneve dhe seminareve, eseve dhe detyrave të kursit, praktikës profesionale, projektit/esesë kërkimore në përfundim të studimit, si edhe shumë elementëve të tjerë formues. Edhe Fakulteti dhe Universiteti me aktivitetet dhe strukturat e tyre, mbështesin formimin e studentëve, duke kontribuar në drejtim të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROÇESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në kuadër të detyrimit ligjor për akreditimin e programit të studimit “Diplome Profesionale: Turizëm”, u ngrit grupi i posaçëm (GVB) që do të merrej me vlerësimin e tij dhe hartimin e raportit, në Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut, i cili mbulon këtë program studimi. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Programit të Studimit “Diplome Profesionale: Turizëm”, i cili u ngrit me Urdhërin e Rektorit të UET, Nr. 15. Prot, datë 21.12.2020², përbëhet nga katër anëtarë, tre anëtarë janë përfaqësues të departamentit, ndërsa anëtari i katër është studente e këtij programi studimi. KSBC dhe drejtimi i UET organizoi dhe zhvilloi trajnimin për orientimin, ndarjen e detyrave dhe mënyrën e plotësimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm. GVB u mblodh së bashku për të vendosur ndarjen e detyrave për secilin anëtar, në përputhje me sqarimet e dhëna në trajnimin e zhvilluar. U mblodhën të dhënat nga departamenti dhe zyrat përkatëse, dokumentacioni në sistemin e brendshëm të UET, si edhe raportet e rregulloret e institucionit. Në bazë të tyre u zhvillua puna për plotësimin e raportit. Më pas u zhvillua një takim i dytë me KSBC për të diskutuar lidhur me ecurinë e procesit. Në vazhdimësi u plotësuan me të dhëna të gjitha rubrikat e raportit, duke krijuar një draft. Ky draft-raport iu dërgua Pergjegjësës së Departamentit dhe të gjithë anëtarëve të departamentit, dhe u diskutua gjatë mbledhjes javore të tij. Bazuar në komentet e bëra nga anëtarët e departamentit, u bënë rregullimet perkatese, duke e përmirësuar më tej raportin. Në përfundim, Raporti i GVB u dërgua tek KSBC dhe organet drejtuese të UET.

² Urdhër Administrativ, Nr. 15. Prot, datë 21.12.2020, Për ngritjen e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm, në kuadër të akreditimit të parë të disa programeve të studimit (Ref. Nr.54)

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Diplomë Profesionale Turizëm”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit “Diplomë Profesionale: Turizëm”, që ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti European i Tiranës, është hapur me: Urdhërin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 567, Datë 09/12/2018 ³ ; Vendimin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Nr. 34 datë 15/05/2018 ⁴ (ndryshuar me Vendimin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Nr.55, datë 30/07/2018 ⁵); Vendimin e Senatit Akademik të UET, Nr. 6, datë 14/06/2018 ⁶ , (ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik të UET, Nr.06/1, datë 31/07/2018 ⁷); si edhe Vendimin e Bordit të Administrimit të UET, Nr. 47, datë 21/06/2018 ⁸ . Programi i studimit “Diplomë Profesionale: Turizëm” është hartuar në përputhje me Misionin e UET të shprehur në Statutin e UET ⁹ , për t’ju dhënë studentëve një edukim cilësor, me qëllim që të ndërtojë një shoqëri të së ardhmes, bazuar në dije. Programi i studimit ka të përcaktuar në Rregulloren e tij, Objektivat e tij ¹⁰ , dhe ofron njohuri në përputhje me Misionin dhe Objektivat e institucionit. Gjithashtu ky program është në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim të Institucionit ^{11,12} , ku UET synon të bëhet një lider në sistemin universitar shqiptar, duke realizuar me cilësi të lartë e standarte ndërkombëtare, misionin e tij në fushen e arsimit të lartë.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë	Statuti, Rregullorja e Institucionit ¹³ , si edhe Urdhri i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë ¹⁴ , përcaktojnë drejtimit prioritarë

³ Urdhër Nr. 567, datë 09/12/2018, për hapjen e Programit të Studimit me Karakter Profesional në “Turizëm”, në Universitetin European të Tiranës (Ref.Nr.54)

⁴ Vendimin Nr. 34 datë 15/05/2018 i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Ref. Nr.54)

⁵ Vendimin Nr. 55. datë 30/07/2018 i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Ref. Nr.54)

⁶ Vendimin Nr. 6 datë 14/06/2018 i Senatit Akademik (Ref. Nr.54)

⁷ Vendimin Nr. 06/1 datë 31/07/2018 i Senatit Akademik (Ref. Nr.54)

⁸ Vendimin Nr.47 datë 21/06/2018 i Bordit të Administrimit (Ref. Nr.54)

⁹ Statuti i Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.2)

¹⁰ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

¹¹ Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 (Ref.Nr.3)

¹² Plani Strategjik 2015-2020 (Ref. Nr.4)

¹³ Rregullore e Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.5)

¹⁴ Urdhëri Nr. 527, datë 04.09.2018 për Riorganizimin e Njësisë Kryesore Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin European të Tiranës (Ref. Nr.54)

drejtimet prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	akademike të programit dhe demonstrojnë se ai është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të tyre. Gjithashtu, edhe Objektivat e Programit të Studimit, të shprehura në Rregulloren e tij, demonstrojnë qartë se programi i studimit “Diplome Profesionale: Turizëm”, është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritare akademike të Institucionit. Studimet në UET, në të gjitha ciklet e studimit, janë si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë, dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës.
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Në Rregulloren e UET ¹⁵ , si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit ¹⁶ , qartësisht tregohet që Programi ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ¹⁷ , i UET. Programi emërtohet “Diplomë Profesionale: Turizëm”, dhe pajis studentët me njohuritë themelore teoriko-praktike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe me përvojën shqipëtare, në fushën e turizmit, përsa i përket funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në këtë fushë. Ai gjithashtu synon ta pajisë studentin me këto aftësi kyçe: njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes; njohuri rreth impakteve ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperience pozitive udhëtimi; njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore; si të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm; të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel, etj.
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Gjatë hartimit të programit të studimit Departamenti është konsultuar me përfaqësues të rëndësishëm të tregut të punës. Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës ¹⁸ dhe të studentëve të Shoqatës “Alumni UET” ^{19, 20} , pjesë e këtij Bordi, pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve ²¹ . UET ka organizuar edhe takime me grupe ekspertësh ²² , në lidhje me atë që universitetet ofrojnë dhe tregjet e punës kërkojnë. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale, me qëllim punësimin në sektorin e turizmit. Ky program gjithashtu, është organizuar, duke u mbështetur edhe në studimet ²³ parapra ²⁴ të zhvilluara nga institucioni mbi nevojat e tregut dhe

¹⁵ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 3, 4, 13 dhe 14 (Ref. Nr.5)

¹⁶ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref.Nr.7)

¹⁷ Urdhëri Nr. 527, datë 04.09.2018 për Riorganizimin e Njësisë Kryesore Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin European të Tiranës (Ref. Nr.54)

¹⁸ Bordi i Tregut të Punës 2017-2018, Departamenti Menaxhim Dhe Marketing (Ref. Nr.16.1)

¹⁹ Plan-Projekt Alumni (Ref. Nr.12.2)

²⁰ UET Alumni Business III/2019 (Ref. Nr.12.3)

²¹ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref.Nr.7)

²² Tryezë konsultuese – Industria e turizmit dhe nevojat për BNJ (Innovation Lab) (Ref. Nr.17.6)

²³ Nisma UET – Universiteti i Biznesit (Ref. Nr.17.4)

²⁴ Programi 250+, Programi 500+ (Ref. Nr.17.5)

	perspektivat ekonomike të vendit. Programi është në përputhje të plotë me kërkesat për zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar, dhe reflekton, kërkesat dhe specifikat e tregut të punës në sferën e turizmit, si edhe zhvillimet në tregun e punës vendas dhe atë rajonal. Programi i hap mundësinë studentëve të punojnë në sektorin publik dhe jo-publikë, si psh: specialistë të turizmit në administratën lokale, menaxherë të shërbimeve hoteliere dhe restorantierie, specialistë agjensish turistike, tour operatorë dhe specialistë të zyrave dhe departamenteve të veçanta që punojnë mbi zhvillimin e turizmit, etj.
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Në UET (Departament) zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës²⁵, ndryshimet përkatëse dhe punësimin, të mbështetura mbi marrëveshjet e lidhura me kompani dhe institucione të ndryshme apo aktivitete të ndryshme të realizuara si: UET open days, PANAIRI I PUNES 2019²⁶, Biznese të ftuar në auditor, takime me Alumni UET, takimet e Bordit të Tregut të Punës, etj. Departamenti ka organizuar dy takime të Bordit të Tregut të Punës²⁷, përkatësisht në Maj, ku Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës, janë marrë në konsideratë²⁸, dhe Nëntor, Forumi i përvitëshëm me bordet e tregut të punës²⁹, 2019. Gjithashtu, UET, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit³⁰ mbështet në mënyrë institucionale studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit. Gjithashtu, kjo zyrë, sëbashku me Shoqatën “Alumni UET”^{31,32}, ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e ish-studentëve të programit të studimit, zhvillimet dhe ndryshimet në tregun e punës, dhe ua vendos ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse aktuale. Edhe në takime të ndryshme të Këshillimit të Karrierës^{33,34}, është diskutuar mbi kompetencat e reja që nevojiten nga tregu i punës. Qëllimi i diskutimeve ka qenë ndërgjegjësimi i studentëve në lidhje me keto kompetenca si dhe qartësimi i perpjekjeve që duhet të bëjnë për t’u pajisur me keto kompetenca, për të qenë sa më konkurrues në tregun e punës.
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga	Studimet e tregut të punës për programet me karakter profesional janë të mbështetura mbi Kontratat, Marrëveshjet dhe Memorandumet e

²⁵ Studim Tregu, (Ref. Nr.17)

²⁶ Panairi i Punës 2019, “Dita e Biznesit në UET” (Ref. Nr.12.1)

²⁷ Bordi i Tregut të Punës 2018-2019, Departamenti Menaxhim Dhe Marketing (Ref. Nr.17.1)

²⁸ Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës, Proces-verbal mbledhje e Bordit të Tregut të Punës. (Ref. Nr.17.2)

²⁹ Universiteti 2030, Forumi i përvitëshëm me bordet e tregut të punës, i përbërë nga ish studentë të UET, për 11 departamente (Ref. Nr.17.3)

³⁰ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

³¹ Plan-Projekt Alumni (Ref. Nr.12.2)

³² UET Alumni Business III/2019 (Ref. Nr.12.3)

³³ Relacion mbi Format me anë të të cilës Universiteti Europian i Tiranës zhvillon këshillimin e karrierës (Ref. Nr.12.4)

³⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Bashkëpunimit të UET të lidhura me kompani dhe institucione të ndryshme në treg³⁵, ³⁶, ³⁷, dhe përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me ato, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar, si edhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. Gjithashtu, UET ka organizuar takime me ekspertë të ndryshëm, në lidhje me atë që universitetet ofrojnë dhe tregjet e punës kërkojnë, me kompani në fushën e turizmit, por edhe me kompani të shumta që departamenti, fakulteti dhe UET ka marrëdhënie, në fusha të tjera, psh, mëposhtë janë disa kompani bashkëpunuese në fushën e turizmit: -Diplomat Hotel -Mrizi i Zanave -Mondial Hotel -Mon Cheri -The Plaza Tirana sha -Dhoma e tregtisë dhe industrisë Tiranë -EHW shpk -Lufra.sh.p.k. -Baboon (food Delivery) -Mokador Albania -Regency Casico Tirana (Taiwan) -Qendra Kulturore Tiranë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Që prej hartimit të programit, por edhe më tej gjatë ecurisë së tij, në përmbushje të objektivave të programit të studimit, për shkak të disiplinave mësimore si edhe veprimtarive formuese të ndryshme të përfshira në të, është i domosdoshëm dhe sigurohet bashkëpunim ndërmjet disa fakulteteve dhe departamenteve të ndryshme të UET, për lëndët respektive, dhe që nuk janë në varësi të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut³⁸ si departamenti përgjegjës për

³⁵ Raporti në lidhje me Mobilitetet e Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)

³⁶ Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis UET dhe institucioneve të tjera (Ref.Nr.34.)

³⁷ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)

³⁸ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref.Nr.6)

	programin e studimit. Përgjegjësi i Departamentit është në kontakt të vazhdueshëm me Drejtuesit e Departamenteve të tjera, që mbulojnë lëndët përkatëse që janë të përfshira në programin e studimit, duke bashkëpunuar për mbarrëvajtjen e programit, që prej ndërveprimit dhe diskutimeve në krijimin e tij, bashkëpunimin gjatë sezoneve të provimeve, zgjidhjen e problemeve apo situatave të ndryshme të sudentëve (në lidhje me çështje akademike, kur burojnë prej departamenteve të tjera), etj.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka lidhur marrëveshje dhe ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit³⁹, me objekt: ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit, etj. Një listë e detajuar e marrëveshjeve të bashkëpunimit gjendet në Aneksat e raportit⁴⁰. Gjithashtu, UET ka krijuar marrëdhënie me biznese dhe institucione edhe në kuadër të Programit të Kooperimit 250+⁴¹, që u vijonë në ndihmë edhe studentëve të Programit të Studimit “Diplomë Profesionale: Turizëm”, (edhe për Praktikant Mësimor dhe Zhvillim Karriere)⁴². Krahas këtyre marrëveshjeve, UET gjatë vitit akademik 2018-2019, ka organizuar Panair Pune dhe Karriere për secilin nga fakultetet. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në të cilin bën pjesë ky program studimi, ofron për studentët mundësi kontakti për Internship-e dhe punësim, me 50 prej kompanive më të njohura në fushën e biznesit. Gjithashtu, në auditor, herë pas here, ftohen personalitete dhe specialistë nga sektori i biznesit, të cilët tregojnë eksperiencën e tyre dhe konkretizojnë marrëdhënien akademi-biznes. Sidoqoftë, duhet theksuar që, që prej Marsit 2020 (semestri i dytë, viti akademik 2019-2020, e në vijim, në kohën që po përgatitet ky raport), efektiviteti i këtyre bashkëpunimeve dhe aktiviteteve nuk ka qenë i duhur, si rezultat i Pandemisë Covid-19.
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Marrëveshjet e bashkëpunimit të njësive përgjegjëse për programin e studimit, pra Departamentit, mund të shihen në tre aspekte kryesore: bashkëpunime të vet njësive, bashkëpunime të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, si edhe Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve (zyra me të cilat departamenti ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi). Departamenti zhvillon, vë në zbatim dhe ndjek ecurinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Gjithashtu, aktiviteti vlerësues i bashkëpunimit (dhe hartimi i raporteve) zhvillohet në mënyrë më të detajuar prej zyrave të përmendura më sipër. Kështu, në lidhje me aspektin e parë, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, në veprimtaritë e tij, kryesisht në analizat që zhvillohen në mbledhjet e departamentit, në mënyrë të vazhdueshme vlerëson bashkëpunimin me partnerët, në të gjitha aktivitetet që lidhin njësinë me ata, si psh: UET Open Days (panaireve të punës), Bizneset dhe Ekspertët e Ftuar në Auditor, Takimet me Alumni, Bizneset dhe Ekspertët në Aktivitete Periodike, Takimet e Bordit të Tregut të Punës, Partnerët e Praktikës

³⁹ Raporti në lidhje me Mobilitetet në Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)

⁴⁰ Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis UET dhe institucioneve të tjera (Ref.Nr.34.)

⁴¹ Programi 250+, Programi 500+ (Ref. Nr.17.5)

⁴² Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5) , pjesë e anekseve të Raportit(Ref.Nr.32)

	Mësimore, Partnerët e Huaj, etj. Sidoqoftë në UET, funksionojnë edhe njësi të specializuara me fokus të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së tyre, krijimin, ruajtjen dhe vlerësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimeve me partneret, të tilla si: Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, si edhe Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve (të përmendura mësipër), me të cilat Departamenti kooperon nga afer. P.sh., në përgatitjen dhe zhvillimin e Praktikave Profesionale të studentëve, ajo organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit përkatës, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës⁴³. Departamenti mbikëqyr dhe ndjek seancat me ekspertët e ftuar në auditor, duke caktuar një pedagog përgjegjës për çdo program studimi (si rregull caktohet pedagogu me statusin e këshilluesit të karrierës, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional dhe karrierës në auditor)⁴⁴. (Në programet me karakter profesional studenti krahas seancave në auditor mund të kryej praktikë edhe në një institucion/organizatë/kompani). Kështu, Zyra e Këshillimit të Karrierës, nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë, e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit⁴⁵. Midis shërbimeve kryesore që ofron zyra janë: zhvillimi i sondazheve të planit të karrierës së studentëve; gjurmimi i studentëve pas diplomimit dhe përpunimi i statistikave mbi Alumnin (sa integrohen në tregun e punës, sa vazhdojnë studimet, etj); krijimi i database me burime të mundësive të ndryshme për punësim, internshipe, bursa studimi, etj. Nga ana tjetër Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve⁴⁶, në përputhje me misionin e vet ka për detyrë të nxisë partneritetet me agjencitë e jashtme dhe bizneset; promovojë studentët e ekselencës nëpërmjet përfshirjes së tyre në projekte; etj⁴⁷ (aktualisht nuk ka pasur mobilitet për studentët që ndjekin programin e studimit (pandemia ka qenë gjithashtu, një faktor i rëndësishëm pengues)).
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Pjesë e marrëdhënieve zyrtare dhe të bashkëpunimit ndërmjet UET dhe botës së biznesit, janë edhe marrëveshjet e nënshkruara me biznese dhe institucione të tjera, për realizimin e praktikave mësimore. Duke qenë se këtë vit akademik (2020-2021) është viti i tretë që Programi i Studimi DP Turizëm është funksional, (në UET këtë vit pritet diplomimi i brezit të dytë të studentëve), aktualisht, praktika profesionale është zhvilluar vetëm 1 herë, në vitin akademik 2019-

⁴³ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm ,Praktika Profesionale (Ref.Nr.7)

⁴⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, B.I Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr.32.1)

⁴⁵ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

⁴⁶ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, C.IV. Parimet e organizimit të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve (Ref.Nr.43.1)

⁴⁷ Raporti ne lidhje me Mobilitetet i Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)

	2020. Duke qenë se semestri i dytë (i vitit akademik 2019-2020) u zhvillua online⁴⁸ për shkak të Pandemisë COVID-19, edhe praktika profesionale u zhvillua online⁴⁹. Kështu (krahas programit të parashikuar në Silabusin e Praktikës⁵⁰) në keto kushte, u ndoq edhe një program shtesë për të zhvilluar një praktikë profesionale sa më fryt-dhënëse për studentët, e cila permblidhet si më poshtë: -java e parë (27 Prill), prezantim i “punëve më të paguara freelance online“, si lidhen ato me degën që studentët kanë zgjedhur, si edhe aspekte të tjera praktike në lidhje me punësimin. - Java e dytë, prezantim nga përfaqësues me pervojë i një kompanie të njohur. - Java e tretë, diskutim me studentët rreth zhvillimit të karrierës së tyre, me pjesëmarrjen e Zv. Rektorës për Zhvillimin Institucional dhe Studentët e UET, Përgjegjëses së Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, si edhe Pedagoges Përgjegjëse për Zhvillimin e Praktikës pranë Departamentit. - Java e katërt, prezantime dhe detyra praktike mbi “mind mapping” dhe “aplikimin e mind mapping në një organizatë”. - Java e pestë, udhezime mbi “shkrimin e raportit të praktikës”. - Java e gjashtë, keshillim i përforcuar me pjesëmarrjen e Keshilluesve të Karrierës. Në lidhje me prezantimin nga përfaqësues me pervojë i një kompanie të njohur, në auditor (online) (në javën e dytë) kanë qenë: -(Në orën e Praktikës dhe Zhvillimit të Karrierës) E ftuar Znj. Nertila Domi, Drejtore e Burimeve Njerëzore, Kompania BigAlb Group, Tema e diskutimit: Sfida e menaxhimit të burimeve njerëzore në kohë pandemie. -(Në orën e Praktikës dhe Zhvillimit të Karrierës) E ftuar Znj. Lauren Bekteshi, (alumni e UET dhe anëtare e Bordit të Tregut të Punës) Drejtore e Marketingut, Kompania Class Event, Tema e diskutimit: Prezantimi punës në Class dhe case study në digital marketing. Krahas aktiviteteve të treguara më sipër, studentet kanë plotësuar edhe dosjen e praktikës, ku Raporti i Praktikes përmban: Cv, Leter motivimi (ku studentët përshkruajnë veten duke kërkuar të punojnë në një kompani), Ese (me tema të përcaktuara rreth punësimit, biznesit, kompanive). Si rregull praktika zhvillohet në këtë formë⁵¹: Praktika profesionale për studentët e programeve me karakter profesional dhe programeve të ciklit të parë ka 5 ose 6 ECTS; pra një detyrim prej 125-150 orë punë, për studentin, të shtrira kryesisht në semestrin e dytë të vitit të fundit
--	---

⁴⁸ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1)

⁴⁹ Vendimi Nr. 2, datë 04/05/2020, i Senatit Akademik të Universitetit Europian të Tiranës, mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 (Ref.Nr.5.3)

⁵⁰ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

⁵¹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, B.I Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr.32.1)

	të studimeve. Nga këto, 28 orë zhvillohen në auditor (14 seanca nga 2 orë), mbi njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe të karrierës që bëhen nga pedagogu Këshillues i karrierës, dhe (10 seanca nga 2 orë) me ekspertë të fushës, 72 ose 92 orë në institucion dhe 25 ose 30 orë punë individuale, në varësi të numrit të krediteve të praktikës. Kjo është e specifikuar edhe në planin mësimor.
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	UET nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit⁵² mbështet në mënyrë institucionale studentët, gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, duke ofruar konsulencë për aplikime dhe duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit. Kjo zyrë, sëbashku me Shoqatën “Alumni UET”^{53, 54}, ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e ish-studentëve të programit të studimit, si edhe zhvillimet dhe ndryshimet në tregun e punës, dhe ua vendos ato në dispozicion studentëve. Gjithashtu, edhe nëpërmjet kontakteve prej marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve të krijuara me kompani dhe institucione në treg, institucioni (UET) informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës nëpërmjet: UET Open Days, Bizneseve dhe Ekspertëve të Ftuar në Auditor, Takimeve me Alumni UET, Bizneseve dhe Ekspertëve në Aktivitete Periodike, Takimeve të Bordit të Tregut të Punës, etj. Disa aktivitete të realizuara janë si mëposhtë: -Në 6 dhe 7 Maj 2019, departamenti organizoi aktivitetin “Zhvillimi i studentit nëpërmjet këshillimit të karrierës”, në të cilin u prezantua oferta akadmeike nga Këshilluesit e Karrierës. -Në 16 Maj 2019, departamenti organizoi aktivitetin “Open days”, të konceptuar si një tërësi aktivitetesh, si “Panairi i Punës”, Leksion i hapur mbi “Burimet Njerëzore”, Takim i “Bordeve të tregut të punës” dhe debat mbi temën “Mundësitë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet lidhjeve të universitetit me tregun e punës”. Në “Panairin e Punës” morën pjesë 79 organizata publike dhe jo publike. -Në 27 maj 2019, departamenti organizoi takimin e radhës për Klubin Studentor “Adam Smith”, në të cilin u diskutua dhe debatua mbi temën “A është Marketingu që krijon nevojat apo nevojat krijojnë marketingun”? -Në kuadrin e “Projektit BLUE_BOOST”, në qershor 2019 u organizua në Durrës seminar dy ditor, me studentë të Dp Turizëm, Bachelor dhe master si edhe partnerët e projektit, të cilët paraqitën idetë e tyre dhe konkuruan në konkursin e projekteve mbi “Nxitjen e potencialit të risive në sektorët blue growth në zonën Adriatiko-Joniane”, të drejtuar nga pedagogët Kreshnik Bello dhe Besarta Vladi. -Departamenti organizoi në muajin Qershor (2019) aktivitetin “Alumni Manaxher” me alumni të departamentit, të cilët shërbejnë si këshillues karriere për studentët e nivelit Bachelor. Gjithashtu, në muajin korrik organizoi aktivitetin “Alumni Sipërmarrës”, një aktivitet

⁵² Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

⁵³ Plan-Projekt Alumni (Ref. Nr.12.2)

⁵⁴ UET Alumni Business III/2019 (Ref. Nr.12.3)

	që synon të forcojë lidhjet me alumni, të inspirojë projekte dhe të krijojë një network. -Prej tre vitesh, në muajin Tetor Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut organizon aktivitetin “Startups Europe Comes to University”, si pjesë e një rrjeti europian të 35 universiteteve dhe 17 shteteve. Gjithashtu, në Nëntor 2019, si në çdo vit akademik organizon “Ditën e Sipërmarrjes”, në kuadër të muajit të sipërmarrjes, kudo në botë. -Në kuadër të projektit Smart-al, në Tetor 2019, u zhvillua tryeza e diskutimit me temë “Propozimi i Metodologjisë për Identifikimin e produktit turistik për projektin “100 Fshatrat”. -Departamenti ka organizuar dy mbledhje të Bordit të Tregut të Punës, përkatësisht në Maj dhe Nëntor, 2019. -Në Nëntor 2020, u organizua aktiviteti "Dita e Sipërmarrjes: në auditorin online të lëndës "Hyrje në biznes", me studentët e vitit të dytë të Fakultetit Ekonomisë, Biznesit e Zhvillimit dhe DP të vitit të parë. Të ftuar: Antoneta Ndreka - LUFRA & DUKAT, Bledian Ismaili – DIAMOND, Valbona Begolli – ALBGROUP, Geri Kuka - OPA&SALT, Klodiana Ajazi - NOVUS MARKETING, Gjovalin Hasanaj – VELEÇIK. -Në Nëntor 2020, në lëndën e Menaxhimit të Cilësisë, morën pjesë (online) ekspert i ftuar në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe ekspert i ftuar në Standartet ISO. -Në Maj 2020, u organizua aktiviteti (online) me temë “Menaxherët e rinj të talentuar”, me të ftuar ekspertë dhe përfaqësues të kompanive: Geri Kuka - OPA Greek Restaurant, Lauren Bekteshi - Revista Klass, Gjovalin Hasanaj – Veleçik, Auron Basha - Basha security. -Në Prill 2020, u organizua aktiviteti me temë “Kënaqësia në punë dhe brandi i punëdhënësit”, me të ftuar në auditor (online) Drejtori i Burimeve Njerëzore të Agna Group z. Artan Koxhuku. -Në Qershor 2019, në kuadrin e lëndës "Bazat e turizmit" ishte i ftuar z. Enver Mehmeti, President i Albtours dhe Premium Beach Hotel, me studentët e menaxhimi profili -turizëm dhe Diplomati Profesionale Turizëm. -Në Qershor 2019, i ftuar në auditor, ishte ekspert i kompanisë Balfin Grup në aktivitetin me temë “Vlerësimi i performancës së Burimeve Njerëzore. Eksperienca Balfin Group”. -Në Mars 2019, është organizuar aktiviteti me temë "Aktorët në territor për të përballuar sfidat e Administrimit Publik në shekullin e ri".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ky program studimi⁵⁵ është i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar me kredite në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe ECTS⁵⁶. Programi i studimit përputhet me ciklin e studimit. Kohëzgjatja e tij dhe forma e studimit bazohet në legjislacionin Shqiptar dhe është e përshtatëshme për këtë PS. Pothuajse të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite dhe informacione të tjera jepen si mëposhtë: -Programi zgjat 2 (dy) vite/4 (katër) semestra. -Në total 120 kredite në dy vite akademike, 60 Kredite/vit. -20 lëndë/pa module + Praktikë dhe zhvillim studenti + Provim formimi/Projekt profesional. -20 provime/lëndë + praktika + diploma (Provim formimi/Projekt profesional). -Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 563 orë, Viti II 632 orë, Gjithësej 1195 orë mësimore në auditor. -Format e mësimdhënies në Planin Mësimor⁵⁷ janë: Leksione, Seminare, Praktikë profesionale, Punim i Diplomës (Provim formimi/Projekt profesional). -Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë, për praktikën dhe për diplomën (Provim formimi/Projekt profesional). -Organizimi i lëndëve/moduleve bashkë me veprimtaritë e tjera formuese dhe punimin e diplomës është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. -Strukturimi i lëndëve/moduleve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit. -Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre. -Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktura qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë. -Shpërndarja e lëndëve është e përshtatshme dhe e krahasueshme me programe të ngjashme brenda dhe jashtë vëndit. -Lëndët janë të organizuara në dy tipologji. Për lëndët e Tipologjisë I, programi parashikon këto forma vlerësimi: a. Provimit përfundimtar (40%), b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%). Për lëndët e Tipologjisë II, programi parashikon këto forma vlerësimi: a. Provimi përfundimtar (40%), b. Provimi i ndërmjetëm (30%), c. Detyrë kursi (20%), d. Niveli i diskutimit në seminare (10%). -Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Si

⁵⁵ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

⁵⁶ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm , 3. Programi i Studimit, dhe Pika 4. Kreditet Praktika Profesionale (Ref.Nr.7)

⁵⁷ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

	veprimtari formuese e programit, ajo është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Sipas Objektivave të Programit të Studimit dhe Aneksit I, të Rregullores së Programit të Studimit⁵⁸, programi i studimit me karakter profesional DP Turizëm, synon përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda fushës së Turizmit, në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Kështu, Programi i studimit, synon ta pajisë studentin me: -Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së turizmit -Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale -Formim qytetar të përgjithshëm -Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative -Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative -Aftësim për promovim personal -Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur. Lista e profesioneve/mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve, është: -Specialist/Teknik Hotelier -Specialist në veprimtari turizmi -Menaxhim eventesh turistike -Punonjës shërbimi në Agjensi Turistike -Specilist projekti -Specilist për mbledhje të dhënash në terren -Specilist përpunimi dhe analizimi të dhënash mbi shërbimet e turizmit.
Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	Programi i studimeve Diplomë Profesionale Turizëm i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike, si dhe trajnim të mirëfilltë profesional në fushën e turizmit, duke u dhënë studenteve më shumë mundësi në tregun e punës. Kështu, Kurrikula⁵⁹ i ndan lëndët sipas veprimtarive formuese, në (A, B, C, D dhe E), Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (A), Disiplina të Formimit Karakterizues të Programit (B), Disiplina të Formimit Profesional (C), Veprimtari Formuese (D), Punimi i Diplomës (E). Gjithashtu, programi i studimit arrin ti pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale duke synuar të përmbushen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Ky program ka objektiva të qarta profesionale, të justifikueshme, të arritshme, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut

⁵⁸ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

⁵⁹ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

	të punës. Kështu, programi i studimit Diplomë Profesionale Turizëm synon ta pajisë studentin me këto aftësi kyçe⁶⁰: - Njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes; - Njohuri rreth impakteve ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperiencë pozitive udhëtimi; - Njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore; - Të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm; - Të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel. Edhe Silabuset e Lëndëve⁶¹ specifike të programit, janë të përshtatshme dhe në koherencë me objektivat formuese dhe me objektivat tërësore të këtij programi studimi.
Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.	Programi i studimit Diplomë profesionale Turizëm merr përsipër të formojë ekspertë dhe specialistë në aspektet veçanërisht praktike, aplikative në fushën e turizmit, hotelierisë, agjensive turistike, etj. Gjithashtu, Programi⁶², i hap mundësi studentëve të tij të punojnë në sektorë publike dhe jo-publikë, si psh: specialistë të turizmit në administratën lokale, menaxherë të shërbimeve hoteliere dhe restorantierie, specialistë agjensish turistike, tour operatorë dhe specialistë të departamenteve të veçanta dhe zyra të zhvillimit të turizmit, etj. Duhet theksuar që programi në fushën e Turizmit është një vlerë e shtuar në ofertën akademike të UET, pasi është drejtim i kërkuar nga tregu i punës, duke qenë se sektori kontribuon së tepërmi në GDP të vendit. Edhe Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut vazhdimisht nxjerr në pah nevojën e tregut për formimin e specialistëve në nivelin operacional për sipërmarrjet turistike, specialistëve në aplikimin e projekteve të lidhura me turizmin, duke marrë në konsideratë pikërisht faktin e përmendur mësipër, që turizmi është shndërruar në një nga sektorët prioritarë për zhvillimin e vendit.
Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit,	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut⁶³, që është përgjegjës për Programin e Studimit Diplomë Profesionale Turizëm, në Vitin Akademik aktual 2020-2021, ka në përbërje stafin, sikurse është specifikuar në Tabelën përkatëse bashkangjitur raportit⁶⁴. Përgjegjësi i departamentit

⁶⁰ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

⁶¹ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

⁶² Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

⁶³ Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit, Tabela 2, pjesë e anekseve të raportit (Ref.Nr.24)

⁶⁴ Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësine kryesore dhe njësinë Bazë, Tabela 1, pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.23)

strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.	sebashku me drejtues të tjerë të Institucionit, është i përfshirë si në procesin e rekrutimit⁶⁵ të personelit akademik të njësisë së tij (saj), si dhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, si psh. përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, karriera profesionale jashtë auditorit, kualifikimet, titujt dhe gradat shkencore, etj, sikurse tregohen në CV të tyre⁶⁶. UET- ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Personeli i angazhuar në programet e studimit me karakter profesional realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET^{67, 68}. Ngarkesa mësimore si dhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale, që realizohen nga personeli akademik, vlerësohen me orë mësimore. Gjithashtu edhe Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i cili mbulon Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut, që është përgjegjës për Programin e Studimit Diplomë Profesionale Turizëm, në Vitin Akademik aktual 2020-2021, përbëhet nga 2 Departamente, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut dhe nga Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm⁶⁹, dhe ka në përbërje stafin, sikurse është specifikuar në Tabelën përkatëse bashkangjitur raportit⁷⁰. Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.
Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin, ose kualifikimin në fushën e përcaktuar. Në Rregulloren e Programit të Studimit⁷¹, përcaktohen qartë objektivat për formimin profesional të studentëve. Kështu, Programi i studimit, synon ta pajisë studentin me: -Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së turizmit -Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale -Formim qytetar të përgjithshëm -Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative -Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative

⁶⁵ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G. Burimet Njerëzore (Ref. Nr.11)

⁶⁶ CV e stafit akademik të programit të studimit (Ref. Nr.20)

⁶⁷ Kontratë model e punës për personelin e brendshëm akademik (Ref. Nr.24.2)

⁶⁸ Kontratë model e punës për personelin e jashtëm akademik (Ref. Nr.24.1)

⁶⁹ Urdhëri Nr. 527, datë 04.09.2018 për Riorganizimin e Njësive Kryesore Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin Europian të Tiranës (Ref. Nr.54)

⁷⁰ Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësine kryesore dhe njësinë Bazë, Tabela 1, pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.23)

⁷¹ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

	-Aftësim për promovim personal -Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur. Programi jep njohuri të përgjithshme dhe bazë në fushën e Turizmit, ku gjithashtu, synon ta pajisë studentin me këto aftësi dhe kompetenca profesionale kyçe: -Njohjen dhe vlerësimin e faktorëve që kushtëzojnë organizimin, financimin, drejtimin, administrimin dhe zhvillimin e sipërmarrjes në një ekonomi të tregut të lirë; -Përvetësimin e analizës së funksionimit të industrisë së mikëpritjes, varësinë reciproke dhe ndikimin mbi faktorët e tjerë politikë, ekonomikë e shoqërorë; -Njohjen dhe përvetësimin e të gjithë njohurive që përmirësojnë efikasitetin e brendshme të organizatës turistike, dhe të funksioneve që lidhen me të; -Orientimin me lehtësi në tregun e punës, etj. Të diplomuarit në këtë program studimi formohen për profesione/mundësi punësimi të cilat janë listuar në Aneksin përkatës bashkëlidhur Rregullores së Programit të Studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve	Programi i studimit me karakter profesional Diplomë Profesionale Turizëm, përmban informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe fushat e mundshme të punësimit. Programi ka objektiva të qarta profesionale, të justifikueshme, të arritshme, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e

të diplomuar në këto programe.	tregut të punës. Këto të dhëna gjenden në Rregulloren e Programit të Studimit⁷², në Kurrikulën e Programit të Studimit⁷³ sikurse dhe në Silabusin e çdo lënde⁷⁴. Programi i studimit DP Turizëm, synon ta pajisë studentin me (Objektivat e Programit): - a.Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; - b.Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; - c.Formim qytetar të përgjithshëm; - d.Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative; - e.Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; - f.Aftësim për promovim personal; - g.Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur. Fushat kryesore të punësimit⁷⁵, për studentët që përfundojnë programin DP Turizëm, janë: 1.Specialist/Teknik Hoteleri 2.Specialist veprimtari turizmi 3.Menaxhim evente turistike 4.Punonjës shërbimi Agjensi Turistike 5.Specilist projekti 6.Specilist mbledhje të dhëna në terren 7.Specilist përpunim dhe analizë të dhënash mbi shërbimet e turizmit. Të dhënat reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe janë sipas Tabelës nr.23⁷⁶, bashkangjitur këtij raporti. Vlen të theksohet, se referuar praktikave të ndjekura nga UET për programet e tjera të studimeve, institucioni ndjek procedurë të qarta për të mbledhur dhe analizuar të dhënat mbi punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve.
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	Programi i studimit DP Turizëm është i organizuar në lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, në përputhje me përcaktimet në fuqi. Programi është i organizuar me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike, dhe i ndarë në katër semestra. Lëndët janë të organizuara sipas kategorive A-E ⁷⁷. Shpërndarja e ngarkesës

⁷² Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

⁷³ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

⁷⁴ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

⁷⁵ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

⁷⁶ Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve, Tabela 23 pjesë e anekseve të Raportit. (Ref. nr. 29).

⁷⁷ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

	mësimore në semestra dhe vite, vlerësohet e balancuar dhe e përshtatshme, duke marrë në konsideratë si përcaktimet në fuqi⁷⁸, ashtu edhe natyrën e programit të studimit⁷⁹. Numri i lëndëve dhe ngarkesa e shprehur në kreditë ECTS, për secilën kategori, është si më poshtë vijon: - Në kategorinë A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme: janë përcaktuar katër lëndë me një ngarkesë prej 19 ECTS. - Në kategorinë B - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën që karakterizon programin, lëndët praktike: janë përcaktuar dhjetë lëndë me një ngarkesë prej 58 ECTS. - Në kategorinë C - LËNDË DËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: janë përcaktuar katër lëndë, me një ngarkesë prej 24 ECTS. - Në kategorinë D - LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: janë përcaktuar dy lëndë dhe komponenti Praktikë dhe Zhvillim Studenti, me një ngarkesë prej 14 ECTS. - Në kategorinë E - DETYRIME PËRMBYLLËSE – është përcaktuar zhvillimi i projektit profesional, me një ngarkesë prej 5 ECTS. Vlen të theksohet se përcaktimet për peshën e shprehur në % për secilën kategori A-E, për programet me karakter profesional, janë përcaktuar edhe sipas VKM nr. 879, datë 18.12.2019⁸⁰, e cila ndryshonte disa element të VKM nr. 41, datë 24.01.2018.
Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Programi i studimit DP Turizëm përmban planin mësimor, në të cilin reflektohen: lëndët e programit të studimit, ngarkesa e shprehur në ECTS, kategoria përkatëse A-E (referuar VKM nr.41, datë 24.01.2018), viti dhe semestri, sikurse dhe ngarkesa për secilin komponent e shprehur në orë në auditor dhe orë punë e pavarur e studentit⁸¹. Vlerësohet se shpërndarja e ngarkesës mësimore, ndarja në komponentë leksion/seminar sikurse dhe raporti midis ngarkesës në auditor dhe puna e pavarur, është e përshtatshme dhe konform përcaktimeve në fuqi.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.	Programi i studimit përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi⁸². Informacione në lidhje me leksionet jepen për çdo temë, dhe detajet për orët e seminarit, janë pjesë integrale e syllabusit të lëndës, në seksionin “Metoda Pedagogjike që do të përdoret në Seminarin e radhës” , e cila

⁷⁸ VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ‘Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë’, i ndryshuar (Ref. nr. 53).

⁷⁹ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁸⁰ VKM nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.41, datë 24.01.2018, të Keshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (Ref.Nr.53)

⁸¹ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁸² Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

	përcaktohet gjithashtu për secilën temë. Ndërsa praktika profesionale zhvillohet sipas syllabusit të vet. Syllabuset hartohen nga titullari i lëndës, konsultohen nga përgjegjësi i Grup Lëndëve dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Syllabuset depozitohen në Departament, dhe i vihen në dispozicion studentëve në fillim të semestrit, nëpërmjet platformës LMS.
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Programi i studimeve DP Turizëm i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike, si dhe aftësi të mirëfillta profesionale në fushën e turizmit⁸³, duke u krijuar atyre më shumë mundësi punësimi në tregun e punës. Programi i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale duke synuar që ato të përmbushen apo zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Ky program ka objektiva⁸⁴ të qarta profesionale, të justifikueshme, të arritshme, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky program është mjaftueshmërisht fleksibël⁸⁵ pasi i hap mundësi studentëve tanë të punojnë në sektorë publike dhe jo-publikë, si psh: specialistë të turizmit në administratën lokale, menaxherë të shërbimeve hoteliere dhe restorantore, specialistë agjensish turistike, tour operatorë dhe specialistë të departamenteve të veçanta dhe zyrave të zhvillimit të turizmit, etj. Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimi i specialistëve të mirëfilltë në fushat praktike të turizmit. Programi Diplomë Profesionale Turizëm është me natyrë aplikative dhe ofron formim kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale në fushën e turizmit dhe industrisë së mikpritjes, me synimin e pajisjes së studentit me aftësi dhe njohuri bazë në këto fusha, për të garantuar një karrierë të suksesshme profesionale. Ky program studimi inkurajon tek studenti mendimin kritik dhe kreativ, nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur në praktikat më të mira vendase dhe të huaja.
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Mësimi dhe vlerësimi praktik në programin e studimit, është i shpërndarë në 3 kategori të ndryshme. Kategoria e parë është komponenti praktik në lëndët e ndryshme (detyrat e kursit, elementët praktik që zhvillohen gjatë seminareve, etj.). Të gjitha këto kombinohen edhe me specialistë dhe ekspertë të fushës, të cilët shpesh janë bërë pjesë e auditorit si të ftuar, si edhe aktivitete të tjera me karakter praktik të organizuara prej departamentit. Kategoria e dytë është komponenti i praktikës profesionale, i përcaktuar në kategorinë D - Praktikë dhe Zhvillim Studenti, me një ngarkesë prej 5 ECTS. Duke qenë se këtë vit akademik (2020-2021) është viti i tretë që Programi i Studimi DP Turizëm është funksional, (në UET këtë vit pritet diplomimi i brezit të dytë të studentëve), aktualisht, praktika profesionale është zhvilluar vetëm 1 herë, në vitin akademik 2019-2020. Duke qenë se semestri i dytë (i vitit akademik 2019-2020) u zhvillua online për shkak të pandemisë, edhe praktika profesionale u

⁸³ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁸⁴ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

⁸⁵ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

	zhvillua online. Kështu, në këto kushte, u ndoq një strukturë e veçantë për të zhvilluar një praktikë profesionale sa më fryt-dhënëse për studentët. Ndërsa kategoria tretë e mësimit dhe vlerësimit praktik në këtë program studimi, është përcaktuar në kategorinë E – ku është përcaktuar zhvillimi i detyrimeve përmbyllëse (Provimit të Përgjithshëm Profesional (Rast Studimi)) , me një ngarkesë prej 5 ECTS. Praktika profesionale është e detyrueshme për t'u ndjekur dhe mbrojtur para një komisioni të posaçëm, pjesë e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, në përmbushje të detyrimeve të studentit para diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Emërtimi ⁸⁶ i programit të studimit Diplomë Profesionale Turizëm, struktura e programit ⁸⁷ , emërtimi i lëndëve ⁸⁸ dhe shpërndarja e tyre në semestra ⁸⁹ , e shprehur në ECTS ⁹⁰ , është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënës dhe punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit, sikurse dhe organizimi i lëndëve në program, është i tillë që të plotësojnë formimin profesional që programi synon ⁹¹ . Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin dhe kompetencat e duhura, kryesisht praktike, për arritjen e objektivave profesionale me qëllim punësimin e studentëve. Kështu, Programi i studimit, synon ta pajisë studentin me: • Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së turizmit • Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale • Formim qytetar të përgjithshëm • Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative • Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative

⁸⁶ Urdhëri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 567, datë 09/12/2018, për hapjen e Programit të Studimit me Karakter Profesional në “Turizëm”, në Universitetin Evropian të Tiranës (Ref. nr. 54).

⁸⁷ VKM nr. 41, datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar (Ref. nr. 53).

⁸⁸ VKM nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.41, datë 24.01.2018, të Keshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (Ref.Nr.53)

⁸⁹ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

⁹⁰ Plan mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁹¹ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

	• Aftësim për promovim personal • Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur. Gjithashtu, programi i studimit Diplomë Profesionale Turizëm synon ta pajisë studentin me këto aftësi kyçe (Objektivat formuese të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundimin e tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi)⁹²: • njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes; • njohuri rreth impaktet ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperiencë pozitive udhëtimi; • njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore; • të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm; • të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel.
Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabusët e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	Elementët e programit të studimit ⁹³ , plani mësimor ⁹⁴ , natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabusët ⁹⁵ e moduleve e të aktiviteteve formuese, janë informues dhe plotësojnë të gjithë kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.	Programi i studimit përputhet me ciklin e studimit. Pothuajse të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite dhe informacione të tjera jepen si mëposhte: 20 lëndë/pa module + Praktikë dhe zhvillim studenti + Provim formimi(PPP)/Projekt profesional. 20 provime/lëndë + praktika + diploma (Provimi formimi(PPP)/Projekt profesional). Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 563 orë, Viti II 632 orë, Gjithsej 1195 orë mësimore në auditor. Sidoqoftë, (megjithatë Kriteri 4 nuk ka qenë i përcaktuar në momentin e aplikimit për licencimin e programit të studimit) nga analiza e përmbajtjes së moduleve dhe aktiviteteve të ofruara nga kurrikula e programit rezulton se raporti me formimin teorik dhe praktik është 51:49 nëse përllogaritet në bazë të krediteve ose 50:50 nëse përllogaritet në bazë të orëve

⁹² Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

⁹³ VKM nr. 41, datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar (Ref. nr. 53).

⁹⁴ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁹⁵ Silabusët e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

	në auditor. Format e mësimdhënies në planin mësimor (Plani mësimor për Programin e studimit me karakter profesional në TURIZËM)⁹⁶ janë: Leksione, Seminare, Praktikë profesionale, Punim i Diplomës (Provimi formimi/Projekt profesional). Strukturimi i lëndëve/moduleve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit, ku praktika profesionale, si veprimtari formuese e programit, është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Gjithashtu, kurrikula rezulton se përmbush edhe kriterin që rreth 25% e programit i ofron studentit aftësim praktik/punë konkrete në profesion. Sikurse është pasqyruar në këtë relacion 29 kredite (ose 24%) e programit përbëhet nga veprimtari të aftësimit praktik/punë konkrete në profesion.
Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sikurse u konstatua dhe në analizën e kriterit më sipër, raportet midis formimit teorik dhe praktik, (të cilat qëndrojnë 50:50 nëse përllogaritet në bazë të orëve në auditor)⁹⁷, mundësojnë arritjen e objektivave formuese dhe janë në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Këto elementë janë mbajtur në konsideratë që në momentin e krijimit të këtij programi studimi. Për më tepër, vijimi i kontakteve të vazhdueshme me përfaqësues nga tregu i punës, garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Ky komunikim me tregun e punës, do të mundësojë edhe në të ardhmen përshtatje të mundshme të programit me evoluimin e kërkesave të tregut të punës. Gjithashtu, klasifikimi i programit të studimit sipas aktiviteteve formuese^{98,99} si më poshtë: • Në kategorinë A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme: janë përcaktuar katër lëndë me një ngarkesë prej 19 ECTS. • Në kategorinë B - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën që karakterizon programin, lëndët praktike: janë përcaktuar dhjetë lëndë me një ngarkesë prej 58 ECTS. • Në kategorinë C - LËNDË DËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: janë përcaktuar katër lëndë, me një ngarkesë prej 24 ECTS. • Në kategorinë D - LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: janë

⁹⁶ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁹⁷ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

⁹⁸ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

⁹⁹ Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9) pjesë e anekseve të Raportit. (Ref. nr.14.2).

	përcaktuar dy lëndë dhe komponenti Praktikë dhe Zhvillim Studenti, me një ngarkesë prej 14 ECTS. Në kategorinë E - DETYRIME PËRMBYLLËSE – është përcaktuar zhvillimi i projektit profesional, me një ngarkesë prej 5 ECTS. mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe përshtatjen me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Në kurrikul¹⁰⁰ dhe plan mësimor¹⁰¹, janë të përcaktuara emërtimet e lëndëve, kategoria ku ato bëjnë pjesë nga A-E, ngarkesa e shprehur në kreditë ECTS, sikurse dhe semestri dhe viti kur ofrohen. Të dhënat e plota mbi përmbajtjen e lëndëve të formimit teorik dhe praktik gjenden në syllabuset¹⁰² e çdo lënde/komponenti. Organizimi i lëndëve dhe moduleve bashkë me veprimtarinë formuese dhe punimin e diplomës është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi¹⁰³. Pothuajse të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite dhe informacione të tjera jepen si mëposhtë¹⁰⁴: - Programi zgjat 2 (dy) vite/4 (katër) semestra. - Në total 120 kredite në dy vite akademike, 60 Kredite/vit. 20 lëndë/pa module + Praktikë dhe zhvillim studenti + Provim formimi (PPP)/Projekt profesional. 20 provime/lëndë + praktika + diploma (Provimi formimi(PPP)/Projekt profesional). - Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 563 orë, Viti II 632 orë, Gjithsej 1195 orë mësimore në auditor. - Format e mësimdhënies në planin mësimor janë: Leksione,

¹⁰⁰ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

¹⁰¹ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

¹⁰² Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

¹⁰³ VKM nr. 41, datë 24.01.2018‘Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë’, i ndryshuar (Ref. nr. 53).

¹⁰⁴ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

	Seminare, Praktikë profesionale, Punim i Diplomës (Provimi formimi/PPP). Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë, për praktikën dhe për diplomën (Provimi formimi/PPP). Strukturimi i lëndëve/moduleve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre. Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktura qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë. Shpërndarja e lëndëve është e përshtatshme dhe e krahasueshme me programe të ngjashme brënda dhe jashtë vëndit.
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Përmbajtja e programit të studimit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit¹⁰⁵, synon ta pajisë studentin me këto aftësi kyçe: - njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes; - njohuri rreth impakteve ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperiencë pozitive udhëtimi; - njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore; - si të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm; - të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel. Këto aftësi dhe shprehje të shprehura si më lart, së bashku me shumë të tjera që studenti i fiton edhe në programin ekstrakurikular¹⁰⁶ (pjesëmarrjet në, dhe takimet me, UET Open Days (panaireve të punës), Bizneset dhe Ekspertët e Ftuar në Auditor, Takimet me Alumni, Bizneset dhe Ekspertët në Aktivitete Periodike, Partnerët e Praktikës Mësimore, etj) që ofron departamenti dhe UET, janë të kërkuara sot nga tregu i punës i këtij sektori.
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Aftësitë e zhvilluara në komponentë të ndryshëm të këtij programi janë të transferueshme dhe të qëndrueshme në kohë. Ndërthurja e aspekteve teorike me aspektet praktike, komponentët e ndryshëm të vlerësimit të vazhdueshëm, të cilat vlerësojnë aspekte të ndryshme të

¹⁰⁵ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

¹⁰⁶ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)

	aftësive të fituara, përmbushin parashikimet e këtij kriteri. Ky program mundëson përfitimin e aftësive të transferueshme¹⁰⁷, pasi i hap mundësi studentëve tanë të punojnë në sektorë publike dhe jo-publikë, si psh: specialistë të turizmit në administratën lokale, menaxherë të shërbimeve hoteliere dhe restorante, specialistë agjensish turistike, tour operatorë dhe specialistë të departamenteve të vecanta dhe zyra të zhvillimit të turizmit, etj Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimi i specialistëve të mirëfilltë në fushat praktike të turizmit. Por duke qenë se ky program studimi inkurajon tek studenti mendimin kritik dhe kreativ, nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur në praktikën më të mira vendase dhe të huaja, ai pajis studentin me aftësi dhe kompetenca të transferueshme dhe të përdorshme edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë.
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit me karakter profesional, duke ofruar njohuri teorike bazë të fushës së studimit; aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës; si edhe aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës. Nga vlerësimi i kurrikulës së programit, konstatohen se ndërthurja e elementëve praktik me ato teorik, mundëson përfitimin e njohurive dhe aftësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik dhe komunikim efektiv me të tjerët.¹⁰⁸ Lëndë të tilla si Hyrje në Sociologji, Shkrim Akademik, Komunikim Ndërkulturor dhe Anglisht, mundësojnë përfitimin e njohurive dhe aftësive, sipas përcaktimeve të këtij kriteri. Në aftësimin dhe shkathtësimin e të menduarit ndihmojnë edhe veprimtaritë ekstrakurrikulare që mbështesin studentët në UET¹⁰⁹.
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, si njësi përgjegjëse për programin e studimit DP Turizëm në bashkëpunim me institucionet publike e private, përditëson, përshtat dhe riorganizon programin në përputhje me kërkesat dhe nevojat kombëtare të zhvillimit. Zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit me punëdhënësit është pjesë e strategjisë së institucionit për të gjithë programet e studimit. Kështu UET vazhdimisht organizon takime me ekspertë të ndryshëm, në lidhje me atë që universitetet ofrojnë dhe tregjet e punës kërkojnë, me kompani në fushën e turizmit, por edhe me kompani të shumta që departamenti, fakulteti dhe UET ka marrëdhënie në fusha të tjera, psh, mëposhtë janë disa kompani bashkëpunuese në fushën e turizmit¹¹⁰: • Diplomat Hotel • Mrizi i Zanave • Mondial Hotel • Mon Cheri

¹⁰⁷ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

¹⁰⁸ Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)

¹⁰⁹ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)

¹¹⁰ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)

	• The Plaza Tirana sha • Dhoma e tregtisë dhe industrisë Tiranë • EHW shpk • Lufra.sh.p.k. • Baboon (food Delivery) • Mokador Albania • Regency Casico Tirana (Taiwan) • Qendra Kulturore Tiranë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Institucioni parashikon qartë si prioritet thelbësor cilësinë e mësimdhënies dhe metodave të përdorura për mësimdhënien, si edhe performancën e stafit akademik të përfshirë në këtë proces. Identifikimi i nevojave për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në institucion realizohet nga sistemi i brëndshëm i menaxhimit të informacionit në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerëzore, duke pasur si prioritet ngritjen e një sistemi të menaxhimit të performancës për personelin akademik. Institucioni ka hartuar dokumentacion dhe ka ngritur struktura të posaçme për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik¹¹¹. Që në departament, në momentin që syllabuset e lëndeve përfundohen prej pedagogeve përkatës, ato rishikohen prej përgjegjësit të grup-lëndës në formë konsultative, dhe miratohen prej përgjegjësit të departamentit, duke kaluar kështu në disa filtra që

¹¹¹ Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit, Tabela nr.6 pjesë e anekseve të Raportit. (Ref. nr. 23.1).

	ndihmojnë në përmirësimin e drejtpërdrejtë të cilësisë së mësimdhënies¹¹². Njëkohësisht në orët e mësimit pedagogët monitorohen dhe vlerësohen prej kolegëve/eprorëve të tyre, dhe për këto vlerësime bëhen diskutime në departament¹¹³. Gjithashtu, UET garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, duke u dhënë atyre të drejtën për të vlerësuar pedagogun dhe cilësinë e orës së mësimi, nëpërmjet vlerësimit me formular/pyetsor anonim nga studenti, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, dhe secilit pedagog në mënyrë të personalizuar¹¹⁴. Studentëve u jepet mundësia e trajtimit të ankimeve, nëpërmjet mbledhjeve mujore të përbashkëta me stafin akademik, në të cilat diskutohen rreth problematikave që mund të kenë hasur gjatë ecurisë së procesit mësimor. Të gjitha këto janë burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e mësimdhënies, metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar. Rezultatet e këtyre vlerësimeve diskutohen edhe në mbledhjet të departamentit. Gjithashtu në institucion funksion edhe KSBC¹¹⁵, e cila është drejtpërdrejtë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. KSBC zhvillon aktivitetin bazuar në planin e veprimit për sigurimin e cilësisë¹¹⁶ dhe metodologjite perkatese të punës për çdo aktivitet¹¹⁷. Aktivitetet kryen në mënyrë periodike dhe KSBC harton relacionet perkatese të cilat i dërgohen Rektoratit dhe/ose Departamenteve perkatese¹¹⁸.
Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që	Në rregulloren e programit të studimit¹¹⁹ Diplomë Profesionale Turizëm, qartësisht janë shprehur format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si: Leksione, Seminarët për çdo lëndë, Ese/Detyra e kursit, Praktika Profesionale, etj. Njëkohësisht në formë më të detajuar edhe në planin mësimor të programit paraqiten veprimtaritë formuese të tij¹²⁰.

¹¹² Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref.Nr.6)

¹¹³ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref.Nr.30.1)

¹¹⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref.Nr. 30.2)

¹¹⁵ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ” (Ref. nr. 8).

¹¹⁶ Plani i veprimit të KSBC (Ref. Nr. 30.3)

¹¹⁷ Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC (Ref. 37.2)

¹¹⁸ Shpërndarja e raporteve të KSBC

¹¹⁹ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

¹²⁰ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	Leksionet dhe seminarët zgjasin për 14 javë (semestri) ^{121, 122} , dhe në javën e 13 të semestrit studentët dorëzojnë detyrat e kursit/ esetë në lëndët e zhvilluara. Praktikë profesionale zhvillohet gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë. Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies qartësisht janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit.
Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Format, mënyrat dhe metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të specifikuar në syllabusin e lëndës ^{123, 124, 125} i cili ndërtohet në përgjigje të nevojave të lëndës dhe studentëve, dhe përmban rubrika si: “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, “Literaturë bazë e detyrueshme”, “Literaturë e rekomanduar”, etj. Në zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren gjerësisht edhe mjete ndihmëse si tabela, kompjuteri, projektori, etj. Metoda të tjera për t’iu përgjigjur diversitetit përfshijnë diskutime dhe punë në grupe me studentet, analiza e rasteve të studimit, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj. Prej gati 1 viti, për shkak të pandemisë, procesi akademik është duke u zhvilluar online, dhe mësimdhënia zhvillohet nëpërmjet përdorimit të dy platformave online UET-LMS, dhe TEAMS ¹²⁶ , të cilat kanë ndihmuar së tepërmi që procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të kryhet sa më normalisht.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	Personi akademik i angazhuar në mësimdhënie përzgjidhet me kujdes. Kështu, Përgjegjësi i Departamentit së bashku me drejtues të tjerë të Institucionit, është i përfshirë si në procesin e rekrutimit ¹²⁷ të personelit akademik të njësisë së tij (saj), ashtu edhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, si psh. përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, karriera profesionale jashtë auditorit, kualifikimet, titujt dhe gradat shkencore, etj (CV të antarëve të Departamentit Menaxhim dhe Marketing) ¹²⁸ . UET-ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Personeli i angazhuar në programet e studimit me karakter profesional realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET ^{129, 130} . Githashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik,

¹²¹ Rregullore e Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.5).

¹²² Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

¹²³ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, A.III Mbi parimet e ndertimit të programit të lëndës (Ref. Nr.39).

¹²⁴ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

¹²⁵ VKM nr. 41, datë 24.01.2018‘Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë’, i ndryshuar (Ref. nr. 53).

¹²⁶ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

¹²⁷ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G. Burimet Njerëzore (Ref. Nr.11)

¹²⁸ CV e stafit akademik të programit të studimit (Ref. Nr.20)

¹²⁹ Kontratë model e punës për personelin e brendshëm akademik (Ref. Nr.24.2)

¹³⁰ Kontratë model e punës për personelin e jashtëm akademik (Ref. Nr.24.1)

	përshkruhen në syllabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset¹³¹ e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave. Në këtë program studimi përdorimi i metodave interaktive dhe diskutimit në mësimdhënie nuk limitohet vetëm për orët e seminareve, por zgjerohet edhe në orët e leksioneve, ku pedagogët përfshijnë edhe materiale audivizuale, që krijojnë situata diskutimesh, duke mundësuar zhvillimin e leksioneve interaktive.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Të gjitha rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të procesit dhe cilësisë së mësimdhënies, diskutohen në mbledhjet e departamentit, ku promovohen shembujt dhe praktikatat më të mira, për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në nivel institucioni njëkohësisht shpallet edhe pedagogu më i mirë i vitit, duke u promovuar kështu përvojat dhe praktikatat më të mira. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet edhe me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, ashtu edhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin në njohjen e specifikave të rregulloreve të UET, si edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimin. Pjesë e trajnimeve të ofruara nga institucioni lidhen dhe me përdorimin e sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, UET-LMS¹³² dhe platformës së mësimdhënies online TEAMS¹³³			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të	Universiteti European i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 11,500 m². Në këtë shifër nuk përfshihet sipërfaqja përreth godinave, një hapësirë e gjerë

¹³¹ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

¹³² UET LMS Guidë për studentët (Ref.Nr.46.3)

¹³³ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

procesit mësimor.	me lulishte e stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina, truall me sipërfaqe rreth 8,600 m². UET ka në dispozicion tre godina: Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m². Në këtë godinë, ndodhet Salla Aula Magna me një sipërfaqe rreth 200 m², me një kapacitet akomodues prej 125 persona. Kjo sallë përdoret në funksion të programeve të Arteve Muzikore dhe Arteve Skenike. Ambienti është i pajisur me një post të konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video. Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m² Në këtë godinë, strehohen laboratorët si më poshtë vijon: Për Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në një sipërfaqe rreth 500 m² strehohen laboratorët: - Laboratori i Arteve Pamore dhe Dizajnit – me një sipërfaqe rreth 250m² - Laboratori i Arteve Skenike – me një sipërfaqe rreth 250m² Për Fakultetin Shkencave Mjekësore Teknike, në një sipërfaqe rreth 260 m² do të strehohen laboratorët: - Laboratori i Biologjisë dhe Histologjisë – 45 m² - Laboratori i Anatomisë dhe Fiziologjisë- 45 m² - Laboratori i Fizioterapisë – 55 m² - Laboratori i Biokimik-Klinik dhe Mikrobiologjik- 55 m² - Laboratori i Infermieristikës- 60 m² Këto laboratorë janë në fazën e finalizimit dhe paisjes me kapacitetet përkatëse didaktike. Për Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, strehohen: - Laboratori i integruar i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës me sipërfaqe rreth 130 m², i cili është në fazën e finalizimit dhe pajisjes me kapacitetet përkatëse didaktike. 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht: - Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) – 160 m². Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m².
--------------------------	--

	Objekti është i pajisur me dy palë shkallë, nga të cilat, në rast emergjence në njërin krah të godinës, mundet të përdoret shkalla tjetër. Gjithashtu, godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si vijon: një fikse zjarri në çdo kat, dhe nga një fikse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 30 copë, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatësisht rrufe-pritëse. Institucioni ka të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike, që përbëhet nga moto gjenerator, si edhe ka të garantuar rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, të cilat realizohen nga rrjeti publik i ujit të pijshëm si dhe pus uji rezervë dhe sistem pompimi përkatës. Mjediset janë të kompletuara me sistemin e ngrohjes të tipit “fan cool”, me komandim qendror. Ky sistem funksionon pa ndërprerje dhe janë çertifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese¹³⁴. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510 m2 dhe 1515 vende. Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45 m2 dhe secila me nga 35 karrige. Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100 m2 secila. Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45m2 secila. Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 10 ambiente me nga 18 m2. Zyra për koordinatorë janë gjithsej 6 ambiente me nga 14m2. Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45m2 secila me kapacitet 35 vende. Sallë interneti me sipërfaqe 165 m2 me 80 kompjuter. Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300 m2, 150 vende leximi. Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150m2. Zyra informacioni për studentët janë 2. Korridore plus holle janë gjithsej 8 me 150 m2 secili. Mjedisi çlodhës për kafe/fastfood/ etj. është në një sipërfaqe të vetme 500 m2. Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300 m2. Zyra për sekretarinë mësimore dhe regjistrarin janë 3 me sipërfaqe 140 m2. Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrains; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.
--	---

¹³⁴ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

	Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shitesë audio vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek.; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet. Biblioteka është e vendosur në Godinën C, me një sipërfaqe prej 300 m² dhe 150 vende leximi. Në bibliotekë janë instaluar 14 pc nëpërmjet të cilave studentët aksesojnë bibliotekat on-line. Krahas infrastrukturës dhe logjistikës fizike që UET disponon dhe ka ofruar në kushtet normale të zhvillimit të procesit mësimor, për shkak të pandemisë, UET po zhvillon procesin mësimor online, përmes platformave LMS dhe TEAMS¹³⁵.
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të procesit mësimor. Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit dhe instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen herë pas here. UET-LMS^{136,137} dhe Teams janë dy prej sistemeve më të përdorura në UET, për proceset akademike. Gjithashtu UET ka domainin e tij , si dhe një rrjet komunikimi të postës elektronike të mundësuar nga outlook. Adresa e e-mailit të çdo pedagogu është emër.mbiemër@uet.edu.al dhe studenti është: Embiemri@uet.edu.al Në mënyrë të veçantë në UET funksionon sistemi i UET LMS (Learning Management System), i cili bën të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura (si: leksione, syllabuset, literatura të detyrueshme dhe literatura të rekomandura, diskutime, njoftime, etj) nga pedagogu, dhe të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe studentet e tjerë të kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët online të detyrave të kursit dhe të seminarit nga kudo që ndodhet.

¹³⁵ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

¹³⁶ UET LMS Guidë për studentët (Ref.Nr.46.3),

¹³⁷ Urdhër administrativ “Mbi zbatim e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS (Ref. Nr. 46.1)

Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse¹³⁸ sikurse tregohet edhe në silabusin e lëndëve¹³⁹ vihet në dispozicion të studentëve për çdo lëndë. Për çdo temë të treguar në syllabus, në UET tregohet literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse që shoqëron atë temë specifike. Përveç kësaj, në fund të syllabusit përsëri vendoset më e plotë literatura bazë dhe ndihmëse, e cila në fillim të semestrit diskutohet me studentët e kursit. Literatura diskutohet në grup-lëndë në mënyrë që ajo të jetë bashkohore, e përshtatshme, dhe të garantojë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Zakonisht preferohet literaturë e 5 viteve të fundit, mbështetur mbi versionet më të fundit të botimeve përkatëse, sipas lëndëve. Literatura e specifikuar në syllabus u vendoset studentëve në dispozicion në formë elektronike në UET-LMS. Gjithashtu një pjesë e saj gjendet në bibliotekën e UET në formë fizike. Literatura për programin e studimit DP Turizëm kërkohet të jetë në gjuhën shqipe.
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage&Ebsco si edhe Questia. Dy platforma të mëdha elektronike nga të cilat studentët mund të lexojnë libra edhe revista kryesisht në gjuhë të huaj. Gjithashtu Biblioteka ka akses edhe në dy platforma elektronike të tjera fal ndihmës së Shoqatës së Bibliotekave, EIFL (Electronic Information for Libraries) janë: ASTM Compass¹⁴⁰, Edward Elgar Publishing – Elgar online platform¹⁴¹ Studentëve u dërgohet linku edhe passwordi dhe ata mund të bëjnë kërkime vet, me fjalë kyçe, me autor, ose titull libri. Abonimi në këto Biblioteka Sage dhe Ebsco¹⁴², është për një periudhë 5-vjeçare. Ndërsa në Bibliotekat e tjera që janë përmendur më sipër Studentët kanë akses të pakufizuar në kohë. Biblioteka UET është pjesë e Sistemit Cobbis.net. i cili është një sistem Slloven që bën katalogizimin e përbashkët të librave dhe gjen shtrirje në shumë vende të Europës Juglindore. Fal këtij sistemi studentet mund të shohin të dhënat Bibliografike të librave që Biblioteka zotëron, por mund të shohin të dhënat bibliografike të librit edhe në rast se ai libër mungon në Bibliotekën e UET-it.

¹³⁸ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, A.III Mbi parimet e ndertimit të programit të lëndës (Ref. Nr.39).

¹³⁹ Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe dytë (Ref.Nr.19.2)

¹⁴⁰ Biblioteka online <https://compass.astm.org/> (Ref.Nr.45)

¹⁴¹ Biblioteka online <https://www.elgaronline.com/> (Ref.Nr.45)

¹⁴² Biblioteka online <http://europs-services.ubt-uni.eu/login.php> , (Ref.Nr.45)

Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UET disponon disa laboratorë të teknologjisë së informacionit që asistojnë studentët të programeve të ndryshme të studimit. Përpara disa vitesh, UET ka inaguruar sallën e re InnoLab, pjesë e një projekti (Innovation Hub) i ideuar dhe i zbatuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe i financuar nga Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim- IADSA, i dedikuar për studentët dhe jo vetëm. Kjo hapësirë e dedikuar shërben jo vetëm për aktivitete të lidhura me natyrën e programin të studimit (Tryezë konsultuese – Industria e turizmit dhe nevojat për BNJ (Innovation Lab) por gjithashtu dhe me klubet studentore aktive të UET. Laboratori i Inovacionit është i pajisur me PC, ambjent për të zhvilluar takime/mbledhje, etj. Gjithashtu vendos ne dispozicion 4 laboratorë mësimorë, të cilët janë të pajisur me PC, vidio projektor dhe mjete audio vizive. Ambjentet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.¹⁴³ E gjithë kjo strukturë laboratorike është në dispozicion dhe shfrytëzohet nga studentët.			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System)¹⁴⁴ dhe Microsoft Teams për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues student apo pedagog¹⁴⁵. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojmë virtualisht edhe nëpërmjet platformës së posaçme Microsoft Teams¹⁴⁶, dhe gjithashtu edhe nëpërmjet emailit. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët që ata zhvillojnë, dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁴³ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

¹⁴⁴ Urdhër administrativ “Mbi zbatim e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS (Ref. Nr. 46.1)

¹⁴⁵ UET LMS Guidë për pedagogun (Ref.Nr.46.2)

¹⁴⁶ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

Standardi III.3 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Në UET është ngritur dhe funksionin KSBC (KSBC në UET)¹⁴⁷, e cila ngrihet në nivel institucional. Antarët¹⁴⁸ e saj propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi¹⁴⁹. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitete të parashikuara në planin e saj të veprimit¹⁵⁰, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Qëllimet e kësaj njësie në funksion të koordinimit dhe bashkërendimit me njësitë kryesore bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie sipas pikës F.VII.3, në rregulloren e KSBC përfshijnë: Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UET-it, duke zbatuar një program akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjike me synimet që ka UET-i; rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur përfshirjen e tyre në vendimarrje¹⁵¹.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka ngritur njësinë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas pikës F.VII.1. mbi organizimin dhe funksionimin e KSBC, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET-it. Objektivat e KSBC-së¹⁵² janë: Monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit të institucionit;

¹⁴⁷ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ” (Ref. nr. 8).

¹⁴⁸ Të dhëna për anëtarët e KSBC, Tabela 24 pjesë e anekseve të Raportit (Ref. nr. 37.1).

¹⁴⁹ Statuti i Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr.2)

¹⁵⁰ Plani i veprimit të KSBC (Ref. Nr. 30.3)

¹⁵¹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ” (Ref. nr. 8).

¹⁵² Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ” (Ref. nr. 8).

	Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes së programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave¹⁵³; Ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; Ndjekja e vazhdueshme e ecures së kërkimit shkencor në institucion; Monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit; Ndjekja e ecures së bashkëpunimit të fakultetit me institucione të tjera akademike dhe joakademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; Shtrirja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat organizative të institucionit. Fakulteti në mbledhjet e veta gjithmonë ka theksuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies si nëpërmjet përdorimit të literaturës më të mirë dhe më bashkohore në syllabuset e lëndëve, teknikave më të mira të mësimdhënies, përdorimit të bazës teknologjike në dispozicion, monitorimit dhe kontrollit të vazhdueshëm të pedagogëve, si edhe komunikimit të pandërprerë me studentët për t'u kuptuar dhe zgjidhur situatat problematike që mund të krijohen , por edhe për të marrë prej tyre informacione të vlefshme për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në mënyrë të veçantë departamentet vlerësojnë performancën e pedagogëve nëpërmjet monitorimeve në orën e mësimit, ku vlerësimi i vihet atyre në dispozicion. Këtij vlerësimi i bashkangjitet edhe vlerësimi prej studentëve , i cili gjithashtu u vihet në dispozicion pedagogëve. Të gjitha këto kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Personeli akademik nëpërmjet literaturës që përzgjedh, temave që përdor, shembujve me të cilët i ilustron, formave të mësimdhënies që përdor, të cilat pasqyrohen në syllabusin e lëndës, dhe që përmirësohen në çdo semester, kontribuon në mënyrë të drejtperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik është pjesë e trajnimeve të vazhdueshme. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore¹⁵⁴ mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimit, leksione/seminare. Ajo raporton në fund të çdo jave, për orët e pazhvilluara te Sekretari i Përgjithshëm, te Dekanët e Fakulteteve dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin i cili ishte i shpallur. Përmirësimi i mësimdhënies dhe implementimi i metodave të reja mundësohet edhe nëpërmjet zhvillimit të leksioneve të hapura; vlerësimit nga studentë; vlerësimit të Dekanit dhe/ose

¹⁵³ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

¹⁵⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)

	Përgjegjësit të Departamentit; vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori, në fund të çdo viti akademik(follow-up), etj.			
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi përgjegjëse që mbulon programin, realizon leksione të hapura me pjesëmarrjen e pedagogëve të huaj apo specialistëve të fushës, edhe me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga stafi i Departamentit. UET nxit përfshirjen e pedagogëve në mobilitete akademike dhe krijon mundësinë për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies, të përfituara prej shkëmbimeve të eksperiencave me pedagogë të Universiteteve partnere jashtë vendit. Gjatë periudhës së programit, ka pasur mobilitet të stafit të departamentit në universitete jashtë vendit, por edhe pedagog të huaj, që kanë ardhur pranë departamentit ¹⁵⁵ . Krahas stafit akademik, pjesë e mobiliteteve janë edhe stafi administrativ. Për shkak të pandemisë, përfitimi i eksperiencës nga mobilitetet dhe implementimi i saj është reduktuar ndjeshëm.			
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Testimi i metodave të reja në mësimdhënie është një praktikë e cila aplikohet në rastet kur stafi akademik pasuron metodat e mësimdhënies si rezultat i eksperiencave nga shkëmbimet dhe mobilitet Erasmus në universitet partnere, me të cilat institucioni bashkëpunon. Njëkohësisht, në këtë drejtim kontribuojnë edhe projektet shkencore, në të cilat një pjesë e stafit të departamentit është pjesë, ku shumë njohuri por edhe metoda të reja të përfituara bëhen pjesë e mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.4 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas	Nga institucioni bëhen publike dhe njihen nga studentët, kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve, si dhe aftësive profesionale ¹⁵⁶ . Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm si: provimit përfundimtar, provimit të ndërmjetëm,

¹⁵⁵ Raporti në lidhje me Mobilitetet i Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)

¹⁵⁶ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës “Sistemi i Vlerësimit”, (Ref. Nr. 5)

afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	detyrë kursi, nivelit të diskutimit në seminare apo detyrave praktike, etj ¹⁵⁷ . Dokumentacioni i vlerësimit ruhet sipas afateve dhe procedurave në rregulloret e institucionit.
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të tregojë sa më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit të mësimdhënies ¹⁵⁸ . Pra, falë kombinimit të disa komponentëve vlerësues, është evidentuar edhe nga fokus-grupet se studentët janë mjaft të kënaqur e të lehtësuar nga kjo shpërndarje dhe forma vlerësimi, e cila u vjen në ndihmë maksimalisht për përgatitjen dhe performimin në provim studentëve. Për shkak të pandemisë, në UET prej gati një viti aplikohet vetëm provimi përfundimtar, dhe rubrika të tjera të vlerësimit të parashikuara në rregulloren tranzitore. ¹⁵⁹
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve ¹⁶⁰ nga titullari i lëndës/modulit. Ata informohen në sistemet e platformave si ¹⁶¹ , LMS dhe TEAMS, apo me anë të postës elektronike në lidhje me format e vlerësimit dhe detyrimeve që duhet të përmbushin lidhur me to. Shkalla e përvetësimit të dijeve ^{162, 163} me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me gërma nga F në A. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga E në A janë kaluese.
Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminon formë të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit ¹⁶⁴ . Shpërndarja e komponentëve të vlerësimit ¹⁶⁵ është në formën: provim përfundimtar, provim të ndërmjetëm, detyrë kursi, niveli i diskutimit në seminar apo detyrat praktike ¹⁶⁶ . Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit elektronik të barkodeve, ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Prej rreth 1 viti , për shkak të

¹⁵⁷ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës Neni 24 “ Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve”, (Ref. Nr. 5)

¹⁵⁸ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr.5)

¹⁵⁹ Rregullore Tranzitore” Për Zhvillimin e Procesit Akademik Gjatë Vitit Akademik 2020-2021, Në Kushtet e Pandemisë Covid-19”, nr.53_2 prot, datë 02.11.2020, Neni.5” Kontrolli dhe vlerësimi i dijes”. (Ref. Nr.5.5)

¹⁶⁰ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

¹⁶¹ Urdhër administrativ “Mbi zbatim e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS (Ref. Nr. 46.1)

¹⁶² Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës “Sistemi i Vlerësimit”, (Ref. Nr. 5)

¹⁶³ Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)

¹⁶⁴ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës “Provimet” (Ref. Nr. 5);

¹⁶⁵ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës neni.17 “Planifikimi I procesit mesimor” (Ref. Nr. 5);

¹⁶⁶ Kalendar akademik (Ref.Nr.10.1, 10.2, 10.3)

	pandemisë, pjesa më e madhe e provimeve është zhvilluar online, provimet e ndërmjetme janë hequr, dhe realizimi i të gjitha rubrikave të vlerësimit të provimit , është bërë nëpërmjet platformës UET LMS dhe TEAMS.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e diplomës me 5 anëtarë, dhe praktikës mësimore me 3 anëtarë. Ndërkohë, për lëndët e programit mësimor vlerësimi i dijeve kryhet nga titullari i lëndës, kur është individ i vetëm, dhe nga të gjithë pedagogët e lëndës kur janë më shumë se një pedagog¹⁶⁷. Vlerësimi i njohurive dhe dijeve në provim dhe detyra kursi/ese shoqërohet me komente. Çdo provim përmban seksionin e vlerësimit të pedagogut për të argumentuar vlerësimin e tij. Pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale mbështeten mbi meritën, ku pedagogu falë sekretimit të tezave nuk është në dijeni mbi identitetin e studentit dhe jepen në kohën e parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Studentët kanë të drejtën e ankimit dhe rivlerësimit, proces i cili zhvillohet gjatë seancave sqaruese, të cilat janë të detyrueshme për çdo lëndë. Seanca sqaruese ju vjen në ndihmë studentëve duke siguruar feedback mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për rishikimin e vlerësimit të provimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Pas zhvillimit të provimit në rast se ndeshet kërkesë apo ankimim, ajo do të shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm, i cili përbëhet nga tre anëtarë, në përbërjen e të cilit nuk është pedagogu i lëndës. Komisioni vendos nëse vlerësimi ka qënë korrekt ose jo, dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas rastit, duke dhënë rezultatin përfundimtar. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimit. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimit. Procedura e ndjekur pasi i është

¹⁶⁷ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

	dhënë zgjidhje respektivisht do të dokumentohet dhe arkivohet 168 .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.	Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënit, të cilat janë: a. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; b. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; c. Formim qytetar të përgjithshëm; d. Aftësi bazë për punë kërkimore aplikative; e. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; f. Aftësim për promovim personal; g. Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon aftësitë e tij brenda profesionit të zgjedhur¹⁶⁹. Rubrikat e programit të studimit janë të plotësuara me lëndë, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e aftësimin profesional të studentit, në përmbushje të objektivave të programit të studimit, sikurse citohen në rregulloren e tij. Programi i studimit përputhet me ciklin e studimit. Kohëzgjatja e tij dhe forma e studimit bazohet në legjislacionin Shqiptar dhe është e përshtatëshme për këtë program studimi. Pothuajse të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite dhe informacione të tjera jepen si mëposhtë: Programi zgjat 2 (dy) vite/4 (katër) semestra. Në total 120 kredite në dy vite akademike, 60 Kredite/vit. 20 lëndë/pa module + Praktikë dhe zhvillim studenti + Provim formimi (PPP)/Projekt profesional. 20 provime/lëndë + praktika + diploma (Provim formimi (PPP) /Projekt profesional). Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 563 orë, Viti II 632 orë,

¹⁶⁸ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 32 “Kërkesa për rivlerësim” (Ref. Nr.5)

¹⁶⁹ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)

	Gjithsej 1195 orë mësimore në auditor. Format e mësimdhënies në planin mësimor (Plani mësimor për Programin e studimit me karakter profesional në TURIZËM)¹⁷⁰ janë: Leksione, Seminare, Praktikë profesionale, Punim i Diplomës (Provimi formimi/Projekt profesional). Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë, për praktikën dhe për diplomën (Provimi formimi/Projekt profesional). Organizimi i lëndëve/moduleve bashkë me veprimtaritë e tjera formuese dhe punimin e diplomës është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Strukturimi i lëndëve/moduleve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre. Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktura qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë. Shpërndarja e lëndëve është e përshtatshme dhe e krahasueshme me programe të ngjashme brënda dhe jashtë vëndit. Lëndët janë të organizuara në dy tipologji. Për lëndët e Tipologjisë I, programi parashikon këto forma vlerësimi: a. Provimi përfundimtar (40%), b. Detyrë praktike: 2 (dy) x 30% = (60%). Për lëndët e Tipologjisë II, programi parashikon këto forma vlerësimi: a. Provimi përfundimtar (40%), b. Provimi të ndërmjetëm (30%), c. Detyrë kursit (20%), d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%). Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Si veprimtari formuese e programit, ajo është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara, duke i përgatitur studentët me njohuri bazë aplikative në këtë fushë si dhe nëndisiplinat përkatëse, si edhe duke synuar formimin e specialistëve me kompetenca të zgjeruara praktike.
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Në syllabusin e çdo lënde përcaktohen "përmbledhja dhe qëllimi i kursit", të cilat në përgjithësi janë konform objektivave të programit të studimit. Më tej temat e

¹⁷⁰ Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)

të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	specifikuara të lëndës kontribuojnë tërësisht në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, studentët marrin njohuri teoriko-praktike të nivelit profesional dhe praktik, që kërkohen nga fusha e turizmit, si edhe aftësi dhe kompetenca, të kërkuara nga tregu i punës. Eksperienca që personeli akademik merr gjatë mobiliteteve në institucionet/universitete partnere, realizimit të projekteve shkencore, si dhe bashkëpunimeve me institucione të tjera akademike, reflektohen në përmirësimin e formave të mësimdhënies. Gjatë shkëmbimit të eksperiencave promovohen universitetet dhe vendet, për të rritur shanset dhe motivimin e studentëve për një eksperiencë jashtë institucionit të tyre¹⁷¹.			
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.	Proçesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të kompetencave dhe aftësive, është një proçes periodik që zhvillohet për secilën lëndë¹⁷². Pas këtij vlerësimi, titullarët e lëndëve në bashkëpunim me përgjegjësit e grup-lëndëve, reflektojnë ndryshimet e nevojshme. Seanca e fundit e seminarit trajtohet në formën e një seance konsultuese që orienton studentët për testin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, çështjet më të rëndësishme, struktura e përgjithshme e tezës sipas seksioneve dhe udhëzime të tjera lidhur me trajtimin e pyetjeve të provimit. Në syllabusin e vitit pasardhës reflektohet edhe përvoja dhe çështjet më të rëndësishme të vitit paraardhës, të cilat bëhen prezente me studentët e rinj.			
Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	Institucioni ka hartuar procedura të posaçme për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen në procesin e diplomimit. Rregullorja e Diplomimit,¹⁷³ Rregullorja e programit të studimit, përmbajnë të gjithë elementet e kërkuara nga ky kriter. Të dhënat e studentëve të diplomuar mbahen në regjistrat zyrtarë të institucionit.			
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Diplomimi bëhet nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)¹⁷⁴ që zhvillohet në formën e rastit studimor, të lidhur ngushtë me lëndët karakterizuese të programit (Kategoria B). Në çdo rast, studenti nuk mund të zhvillojë PPP, pa shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit¹⁷⁵. Përpara zhvillimit të PPP, pedagogë të ndryshëm orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e tij. Në fund provimi korrigjohet prej grupit të pedagogëve që kanë kontribuar për pyetjet, dhe nota përfundimtare del si rezultat i shumës së vlerësimeve të secilit pedagog.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹⁷¹ Raporti ne lidhje me Mobilitetet i Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)

¹⁷² Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes (Ref. Nr.39).

¹⁷³ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Diplomimi) (Ref. nr. 7).

¹⁷⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes (Ref. Nr.39).

¹⁷⁵ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikase dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Universiteti European i Tiranës i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme ^{176, 177} . UET-ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Personeli i angazhuar në programet e studimit me karakter profesional realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm, ekspertizat dhe ngarkesën mësimore të tyre. Ngarkesa mësimore si dhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale, që realizohen nga personeli akademik, vlerësohen me orë mësimore dhe përputhen me nivelin e kualifikimit dhe përmbajtjen e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo	Të dhënat për personelin mblidhen, ruhen dhe përditësohen për çdo vit akademik, nga Zyra e Burimeve Njerëzore ¹⁷⁸ , e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik si për atë me kohë të plotë ¹⁷⁹ , edhe për atë me kohë të pjesshme ¹⁸⁰ , në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni. Çdo vit i gjithë stafi i përfshirë në programin e studimit raporton në lidhje me përditësimet e CV-së së vet, publikimet dhe konferencat shkencore, realizimin e ngarkesës mësimore për secilin semester, projektet shkencore të realizuara, aktivitetet shkencore të

¹⁷⁶ Statuti i Universitetit European të Tiranës Neni 44 (Ref. Nr. 2)

¹⁷⁷ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G. Burimet Njerëzore (Ref. Nr.11)

¹⁷⁸ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G. Burimet Njerëzore (Ref. Nr.11)

¹⁷⁹ Lista e dokumentacionit që përmban dosja individuale staf akademik me kohë të plotë (Ref. Nr. 44.1)

¹⁸⁰ Lista e dokumentacionit që përmban dosja individuale staf akademik me kohë të pjesshme (Ref. Nr. 44.2)

vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.	pritshme, të ftuarit në auditor, etj. Këto të dhëna i raportohen fillimisht (Përgjegjësit të Departamentit) departamentit, përpara se të depozitohen në Zyrën e Burimeve Njerëzore.
Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Personeli akademik është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit, dhe këtë Institucioni e dëshmon nëpërmjet kontroleve dhe vlerësimeve për personelin akademik. Departamenti përgjegjës për programin e studimit, nëpërmjet kordinatorës së tij ndjek ecurinë e veprimtarive formuese në përmbushje të objektivave të programit, që nga realizimi i orëve mësimore, ese-ve dhe detyrave të kursit, Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar etj. Këto evidenca dërgohen tek zyrat përkatëse në nivel institucional. Gjithashtu Departamenti (dhe Institucioni) vlerëson në mënyrë periodike të gjithë aktivitetin mësimdhënës të stafit akademik nëpërmjet, vlerësimeve të pedagogëve nga studentët ¹⁸¹ , vlerësimit të pedagogëve prej eprorit/kolegut ¹⁸² , mbledhjeve të hapura me studentët ¹⁸³ , si edhe vlerësimit të përgjithshëm disa vjeçar që kryhet në nivel institucional ¹⁸⁴ . Gjithashtu, departamenti mbështet stafin akademik për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive. Institucioni ka mundur një mjedis të përshtatshëm i cili lehtëson dhe mundëson kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Ky mjedis është i garantuar në terma të infrastrukturës fizike dhe asaj teknologjike. Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë të shumta, si: Salla për leksione; Klasa për seminare; Salla për veprimtari promovuese; Salla për praktikë profesionale; Laboratorë informatike; Salla për bibliotekë etj. Të gjitha sallat mësimore (leksione dhe seminare) janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET ¹⁸⁵ .
Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Kështu UET here pas here organizon trajnime për stafin akademik, ku në mënyrë të veçantë gjatë semestrit të dytë të vitit të shkuar dhe semestrit të parë të vitit aktual janë organizuar trajnime online në lidhje mësimdhënien në përshtatje me kushtet e pandemisë COVID-19. Në këto trajnime janë dhënë informacione për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja si: përdorimi i platformës TEAMS (për mësimdhënien) dhe LMS (për të gjitha aktivitetet e tjera formuese) ¹⁸⁶ . Ndër këto trajnime përmendim: trajnimi me temë “Trajnimi i stafit për platformën Teams” në kuadër të

¹⁸¹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref.Nr. 30.2)

¹⁸² Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref.Nr.30.1)

¹⁸³ Procesverbal i Mbajtjes së Mbledhjes me Studentët (Ref.Nr.tjera)

¹⁸⁴ Dokumenti/ Evidence mbi matjen e performances/follow up (Ref.N.54)

¹⁸⁵ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

¹⁸⁶ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

	zhvillimit të mësimet online për shkak të situatës së krijuar nga pandemia prej virusit SARS CoV-2; trajnimi UET¹⁸⁷ LMS¹⁸⁸ për strafin akademik etj. Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti gjithashtu mbështesin stafin akademik për kualifikimin e mëtjshëm profesional. UET mbulon shpenzimet për pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime në vend dhe jashtë vendit, nëpërmjet granteve, gjithashtu ekziston një nxitje dhe motivim institucional për bashkëpunim me institucionet homologe në rajon dhe jashtë vendit. Institucioni nxit publikimin e artikujve, pjesëmarrjen në konferenca, projekte, mobilitete jashtë vendit, etj. Institucioni gjithashtu vendos në dispozicion të publikimeve “Revistën Economicus”¹⁸⁹ dhe Konferencën Ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”¹⁹⁰.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UET ka në dispozicion tre godina. Godina A dhe B të përbëra nga 4 kate, dhe Godina C e cila shërben si biblioteka e Universitetit ¹⁹¹ . Numri i studentëve pjesë e grupit të Diplomë Profesionale Turizëm, është brenda standartit të kërkuar. Konkretisht, numri i studentëve që kanë ndjekur gjatë viteve dhe ndjekin këtë vit akademik programin e studimit Diplomë Profesionale Turizëm është si vijon: 2018-2019 14 studentë, 2019-2020 14 studentë dhe në vitin aktual 2020-2021 janë 3 studentë ¹⁹² . Duke qënë se numri i studentëve nuk është shumë i madh, mundësohet një përkushtim mjaft i madh i institucionit ndaj studentëve të programit.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë të shumta, si: Salla për leksione; Klasa për seminare; Salla për veprimtari promovuese; Salla për praktikë lëndore/profesionale; Laboratorë informatike; Salla për bibliotekë; Innolab; Zyrë informacioni për studentët; Mjediset për aktivitetet e Qeverisë Studentore; dhe hapësira të tjera. Të gjitha sallat mësimore (leksione dhe seminare) janë të pajisura me mjete audio vizive si kompjutera e projektore. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET. Pajisjet dhe infrastruktura në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në

¹⁸⁷ Trajnim mbi sistemin UET LMS (Ref.Nr. 46.1)

¹⁸⁸ UET-LMS -Guidë për pedagogun (Ref.Nr.46.2)

¹⁸⁹ Revista Economicus (Ref.Nr.45.4)

¹⁹⁰ Ditët e Studimeve Shqipëtare (DSSH) 2019-2020 (Ref.Nr.55)

¹⁹¹ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

¹⁹² Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21) Pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.27)

	përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit bashkëkohor të mësimdhënies dhe mësimnxënies¹⁹³. Prej rreth një viti procesi akademik është duke u zhvilluar online dhe për mbarëvajtjen e procesit UET ka vendosur në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve platformat mësimore UET-LMS dhe Teams¹⁹⁴.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i paisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen herë pas here. Prej rreth një viti procesi akademik është duke u zhvilluar online dhe për mbarëvajtjen e procesit UET ka vendosur në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve platformat mësimore UET-LMS dhe Teams¹⁹⁵.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	UET disponon disa laboratorë të teknologjisë së informacionit¹⁹⁶ që asistojnë studentët të programeve të ndryshme të studimit. Përpara një viti, UET ka inaguaruar sallën e re InnoLab, pjesë e një projekti (Innovation Hub) i ideuar dhe i zbatuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe i financuar nga Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim- IADSA, i dedikuar për studentët dhe jo vetëm. Kjo hapsirë e dedikuar shërben jo vetëm për aktivitete të lidhura me natyrën e programin të studimit (Tryezë konsultuese – Industria e Turizmit dhe nevojat për BNJ (Innovation Lab)¹⁹⁷ por gjithashtu dhe me klubet studentore aktive të UET. Laboratori i Inovacionit është i pajisur me PC, ambjent për të zhvilluar takime/mbledhje, etj.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Praktika profesionale për programin e studimit Diplomë Profesionale Turizëm realizohet 14 javë (28 orë gjithsej) në salla leksionesh. UET zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikës mësimore në auditor. Praktika në Institucion këtë vit akademik, në kuadër të situatës së rrezikshmërisë së lartë për përhapje të SARS-CoV-2, nuk është zhvilluar në Institucione/Kompani, edhe pse UET ka vënë në dispozicion të studentëve për praktikën profesionale një numër të konsiderueshëm Institucionesh/Kompanish me të cilat UET bashkëpunon. Lista me Institucionet e zhvillimit të praktikës profesionale gjendet bashkëlidhur në Aneksat e Raportit¹⁹⁸.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁹³ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

¹⁹⁴ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

¹⁹⁵ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

¹⁹⁶ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

¹⁹⁷ Aktivitetet e organizuara në kuadër të programit të studimit (Ref.Nr.tjera)

¹⁹⁸ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e Universitetit European të Tiranës disponon literaturë që ndihmon studentin (pa pagesë) në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse ¹⁹⁹ . Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit. Biblioteka është e pajisur me PC/wi-fi në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS ²⁰⁰ (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	UET siguron tekste mësimore cilësore, që përcaktohen në silabuset e çdo lënde. Biblioteka disponon: 6425 tituj në total nga të cilët: 1392 janë tituj që i shërbejnë Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Ndër titujt e librave, 4931 janë tituj në gjuhën shqipe dhe 1466 janë tituj në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht). Ndër titujt e revistave dhe periodikëve, 105 tituj janë në gjuhën shqipe dhe 67 tituj janë në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht). Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Të dhëna të detajuara gjenden në dokumentin Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit ^{201, 202} .
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për	UET disponon bibliotekën, ku, pasurimi i fondit të saj ²⁰³ bëhet përmes: blerjeve ²⁰⁴ në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e lëndëve përkatëse të kurrikulave ²⁰⁵ shkollore si tekstet bazë ose si

¹⁹⁹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (Ref.Nr.45.2)

²⁰⁰ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VI. Mbi sistemet e informacionit në funksion të procesit akademik (Ref.Nr.46)

²⁰¹ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit (Ref.Nr.42)

²⁰² Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17), Pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.45.1)

²⁰³ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (Ref.Nr.45.2)

²⁰⁴ Shembull procedurë blerje literature (Ref.Nr.45.3)

²⁰⁵ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13)

shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	literaturë e rekomanduar; blerjeve në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti të botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor, përkthimi dhe botimi nga UET Press i shumë teksteve, që kanë për autorë pedagogë të UET, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë; si dhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga UET; porosive dhe blerjeve online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet me së miri ekspertiza e UET. Gjithashtu UET ka kryer disa abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik shumë tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku mund të përmenden: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia. Gjithashtu UET ka akses edhe në dy platforma të tjera elektronike falë ndihmës së Shoqatës së Bibliotekave, EIFL (Electronic Information for Libraries) si : ASTM Compass dhe Edward Elgar Publishing – Elgar online platform.
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Nëpërmjet bashkëpunimit dhe punës së realizuar nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve²⁰⁶, universiteti siguron jo vetëm financime dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore por edhe bashkëpunime me agjenci të jashtëme (në mënyrë të veçantë me institucionet e huaja) dhe biznese që i vijnë në ndihmë të programeve mësimore dhe studentëve direkt. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm (të brendshëm dhe të huaj), të angazhuar në realizimin e programit mësimor²⁰⁷, u lehtëson dhe garanton studentëve mbështetje dhe përdorimin e burimeve dhe logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere.
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Buxheti financiar hartohet në muajin nëntor-dhjetor të çdo viti dhe miratohet. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Të gjitha këto janë të pasqyruara në raportin financiar të përvitshëm të institucionit.
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të	Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen ²⁰⁸.

²⁰⁶ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, C.IV. Parimet e organizimit të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve (Ref.Nr.43.1)

²⁰⁷ Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)

²⁰⁸ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18) Pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.50)

programit të studimit e në vijim.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore të cilat gjenden të detajuara në dokumentet e institucionit. Përmes këtyre dokumenteve, studentët sqarohen për procesin e pranimit dhe kriteret që duhet të plotësohen për pranim në programet e studimit dy- vjecare, strukturën e studimit, programin e lëndëve, kreditet e nevojshme për t'u diplomuar, mënyrën e vlerësimit, procesin e diplomimit dhe gjithçka tjetër që studentit mund t'i duhet gjatë studimeve të tij ²⁰⁹ . Në dokumentet e UET shprehet qartësisht se të njëjtat rregulla aplikohen për të gjithë dhe të vetmet raste përjashtimore janë studentët me nevoja të veçanta, për të cilët ka rregullime të veçanta në lidhje me procesin mësimor. Institucioni ka hartuar dokumente që përmbajnë informacion të detajuar në lidhje me politikat dhe procedurat që ndiqen, si edhe të gjitha shërbimet e ofruara për studentët me aftësi të kufizuar ²¹⁰ . Kjo gjë forcohet edhe në rregulloren e UET ku në të drejtat e studentit shprehimisht thuhet: “Të jetë i barabartë, por i ndryshëm” ²¹¹ .
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	Përpara fillimit të çdo viti akademik në faqen e internetit të universitetit ²¹² , në faqen e facebook-ut, në njoftimet që bëhen në UET, në “Gjimnaz Tour-et”, studentët njoftohen në kohë për mënyrën e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme ²¹³ . Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të UET-it dhe sipas kriterëve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga Dekanati. Numri i maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik, para fillimit të regjistrimeve. Në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET për studentët e rinj.

²⁰⁹ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref.Nr.7)

²¹⁰ Urdhër për vlerësimin e studentëve me aftësi shikimi të kufizuar (Ref.Nr.5.2)

²¹¹ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës neni 42 pika h. (Ref.Nr.5)

²¹² Të dhëna nga Faqja zyrtare e Web (<https://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/?lang=sq>) (Ref.Nr.47)

²¹³ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.I.1.3. Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim (Ref. Nr. 27.1)

Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.	Në dokumentet e UET sqarohen se cilat janë parimet e pranimit, kriteret e pranimit të studentëve²¹⁴ si edhe se si kryhen transferimet, njohja e krediteve dhe praktikat profesionale në kuadër të programit të studimit. Gjithashtu, studentët marrin informacion të hollësishëm për mënyrat e vlerësimit të dijeve ²¹⁵ (për procedurat e përparimit akademik të tyre) të cilat ndahen edhe nëpërmjet sistemeve mbështetëse të mësimdhënies (LMS).Kështu në sistemin LMS pedagogët vendosin të gjitha vlerësimet përkatëse të lëndës dhe studentët nëpërmjet aksesit që kanë , në cdo moment mund të informohen për vlerësimet e tyre. Në dokumentet e UET(dhe në rregulloren e programit të studimit)²¹⁶, sqarohet se cilët janë elementët kryesorë të kontrollit të vazhdueshëm (provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare), mënyra e organizimit dhe e vlerësimit sipas tipologjive përkatëse. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi; Përmirësimi; Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar. Në lidhje me diplomimin, informacionet (e bazuara mbi dokumentet e UET) të cilat u jepen studentëve, sqarojnë me detaje strukturën e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, burimet e përgatitjes për provimin (të përmbledhur në formën e një materiali orientues), kohëzgjatjen, rregullat për respektim dhe mënyrën e vlerësimit. Gjithashtu aktivitetet e organizuara në nivel departamenti me aktorë dhe ekspertë bashkëpunues dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme punëdhënëse, synojnë të përgatisin studentët për përballjen me tregun e punës.
Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon informacione të posaçme dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Universiteti angazhon burime njerëzore në informimin e hollësishëm para dhe gjatë procesit të regjistrimit, nëpërmjet Zyrës së Pranimeve, si dhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese si broshura e fletëpalosje. Gjithashtu një mënyrë tjetër informimi për studentët e ardhshëm është nëpërmjet “Gjimnaz Tour-eve” që universiteti realizon. Këto tour-e kanë si qëllim dhënien e informacioneve specifike për mundësitë e studimit në programet që UET ofron, duke u kujdesur që kandidatët potencialë të kenë kuptuar qartësisht dhe të vlerësojnë mundësinë individuale për tu bërë pjesë e programeve. Duke qenë se këto tour-e realizohen gjatë semestrit të dytë të vitit akademik, koha e vënë në dispozicion për aplikim është e mjaftueshme për t’a kuptuar mirë procesin dhe për të përgatitur një aplikim të mirë. Në fillim të çdo viti akademik organizohet në UET java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve, të procedurave administrative dhe zhvillimit të procesit mësimor në UET, për të gjithë studentët përfshirë dhe ata të rinj.

²¹⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.I.1.3. Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim (Ref. Nr. 27.1)

²¹⁵ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, A.IV.Sistemi i vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.2)

²¹⁶ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref.Nr.7)

Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacion i detajuar në lidhje me lëndët (sipas kategorise përkatëse: A-Lëndë Bazë, B-Lëndë karakterizuese, C-Lëndë të Formimit Profesional , D- Lëndë plotësuese dhe E- Detyrime përmbyllëse) gjendet në Web-faqjen e Universitetit ²¹⁷ . Sekretaria, koordinoret e programit dhe pedagogët përmes kryerjes së funksioneve të tyre, janë përgjegjës për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin mësimor të studentëve duke e vendosur atë në dispozicion të studentëve. Një procedurë tjetër e rëndësishme informative për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, jepet edhe gjatë javës së përzgjedhjes së lëndëve përpara çdo semestri, si prej këshilluesve të karrierës dhe prej regjistruarëve të lëndëve.			
Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni ndahet me stafin e universitetit nëpërmjet databazës “Dokumenta UET”, ndërsa studentët kanë mundësi të aksesojnë informacionin edhe në distancë nëpërmjet platformës UET LMS ²¹⁸ , ku lehtësisht mund të aksesojnë informacione në lidhje me lëndët e programit të studimit, numrin e krediteve, modalitetet e vlerësimit, detyrimet akademike, orarin përkatës dhe njoftime të rëndësishme që ndahen në rrjet. Të gjitha këto sigurojnë një informim të mirë të studentëve në lidhje me ecurinë e studimit dhe janë lehtësisht të aksesueshme në çdo moment nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Institucioni disponon sistem të menaxhimit të Informacionit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës. Në UET ekzistojnë dy sisteme të tilla: sistemi i brendshëm UET-LMS, dhe sistemi zyrtar UMIS ²¹⁹ .
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në çdo zyrë të stafit akademik dhe administrativ, në kompjuterat përkatës gjendet databaza e Institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”, ku secili anëtar i institucionit mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet, dhe çdo informacion dhe dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit. Sistem tjetër që përdoret është

²¹⁷ Të dhëna nga faqja zyrtare e web (<https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/Turizem.pdf>) (Ref.Nr.47)

²¹⁸ Trajnim mbi sistemin UET LMS (Ref.Nr. 46.1)

²¹⁹ Manual i përdoruesit të sistemit UMIS (Ref. Nr. 46.4)

	sistemi UET-LMS që kryesisht lidhet me procesin mësimor, dhe duke qënë se prej një viti aktiviteti akademik po zhvillohet online për shkak të Pandemisë, në UET po përdoret edhe sistemi Microsoft Teams që lidhet vecanërisht me mësimdhënien online ²²⁰ .			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ofron informacion lidhur me çdo hap të procesit mësimor dhe akademik, i cili mund të aksesohet nga personeli akademik në databazën e Institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”. Ndërsa pedagogët dhe studentët kanë akses mbi informacione në lidhje me procesin mësimor për lëndët përkatëse në të cilat rregjistrohen, në platformën UET LMS. E njëjta gjë vlen, prej një viti edhe për platformën Microsoft Teams.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojmë virtualisht nëpërmjet platformës së posaçme UET LMS dhe Microsoft Teams, dhe gjithashtu edhe nëpërmjet email-it. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët që ata zhvillojnë, dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve, në UET analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive UET LMS dhe Microsoft Teams, për lëndët dhe grupet e veta. Personi përgjegjës (Zyra e IT e UET) për menaxhimin e platformës UET LMS dhe Teams, dërgon në fund të çdo semestri, Raportin mbi aktivitetin e pedagogut në platformat interaktive, duke mundësuar raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen web të UET pasqyrohen informacione lidhur me të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni, informacion lidhur me personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve përkatëse (kualifikimi dhe CV bio e personelit akademik) ²²¹ dhe çdo aktivitet në kuadër të veprimtarisë kërkimore shkencore, leksioneve të hapura si dhe leksioneve nga të ftuar të shquar të botës së biznesit dhe akademisë. Të gjitha këto informacione publikohen në faqen web të institucionit në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²²⁰ URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19 (Ref.Nr.5.1).

²²¹ Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB Informacione për stafin dhe CV bio e stafit akademik të programit të studimit <https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit/> (Ref.Nr.47)

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në statutin dhe rregulloren e UET ²²² qartësisht tregohet baza ligjore mbi të cilën operon institucioni. Informacioni lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit është lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga publiku nëpërmjet informacioneve të vendosura në website-n e institucionit ²²³ , kontaktit me zyrën e pranimit dhe me pedagogët e këshillimit të karrierës ²²⁴ . Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që nga pranimi dhe deri në përfundim të studimeve në ciklin e parë të studimit Diplomë Profesionale. Për këtë mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të tij ²²⁵ .
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Diplomë Profesionale Turizëm ^{226, 227} .	Politikat dhe procedurat në këtë program studimi, nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Diplomë Profesionale Turizëm ^{226, 227} .
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në Diplomat me karakter profesional në përgjithësi dhe në DP Turizëm në veçanti, të cilat janë në përputhje me ndryshimet e mundshme në legjislacionin përkatës. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet informacionit në website-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë (gjimnaz tour) etj ²²⁸ .
Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve,	Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë, kordinatorëve të departamenteve, regjistruarëve të lëndëve dhe platformave elektronike (UET-LMS & UMIS) institucioni vë në dispozicion dhe ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje

²²² Statuti i Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr.2)

²²³ Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB <https://uet.edu.al/new/aplikimet-dhe-pranimet/?lang=sq> (Ref.Nr.47)

²²⁴ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 5)

²²⁵ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 5) Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP-Turizëm (Ref.Nr.7)

²²⁶ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës neni 11 (Ref.Nr.5).

²²⁷ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref.Nr.7)

²²⁸ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.I.1.3. Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim (Ref. Nr. 27.1)

kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik. Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së përkujdesit për studentët, zyra e këshillimit të karrierës, sekretarisë dhe departamentit përkatës institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme²²⁹.			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit²³⁰ dhe Silabusi²³¹ i secilës lëndë, përmban informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit Diplomë Profesionale Turizëm. Studentët e aksesojnë informacionin nëpërmjet silabus-eve, në mënyrë direkte në UET LMS dhe në çdo moment pranë zyrës së sekretarisë ose koordinatorëve të programit të studimit. Në fillim të çdo semestri, silabusi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve u shpjegohen atyre dhe diskutohen nga pedagogu. Institucioni ka dokument të shkruar²³² dhe ofron informacionin e duhur për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e përgatitjes së Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) (diplomimit) në programin e studimit. Kjo gjë bëhet gjatë këshillimit në fillim të vitit akademik, dhe më pas në semestrin e dytë, dhe gjatë periudhës së përgatitjes për PPP zhvillohen seancat orientuese ku pedagogët japin informacion në lidhje me mënyrën e zhvillimit të PPP.			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike institucioni organizon: takime me studentët potencialë (gjimnaz tour), publikimet e informacioneve të rëndësishme në web-site e UET, pritjet e të interesuarve në hollin e Universitetit, organizimin e javës së orientimit akademik, etj, me qëllim për të informuar të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit²³³.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi

²²⁹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.II.Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve (Ref. Nr. 28)

²³⁰ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref.Nr.7)

²³¹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, A.III Mbi parimet e ndertimit të programit të lëndës (Ref. Nr.39).

²³² Formati për Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar (Ref.Nr.7.3)

²³³ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.I.1.3. Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim (Ref. Nr. 27.1)

Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Që në momentin e aplikimit, regjistrimit por edhe në vazhdim, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Diplomë Profesionale në Turiëm nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët këshillues. Gjithashtu ky informacion gjendet i publikuar në faqen web²³⁴ ku çdo student ka akses. Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Këto informacione dhe dokumenta merren dhe gjenden në zyrën e sekretarisë dhe koordinatorëve, në UET LMS, në website-n e institucionit²³⁵. Gjithashtu në fillim të secilit semester UET organizon javën e orientimit akademik dhe studentët pajisen në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike me të gjithë silabuset e lëndëve dhe informacionet e tjera.			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit për Studentët²³⁶, marrëveshjeve të krijuara me kompani dhe institucione në treg, institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës (UET open days, Biznese të ftuar në auditor, Alumni, biznese në aktivitete, bordet e bordit të punës, Panairë të punës të organizuara nga Universiteti etj). Zyra e keshillimit të Karrierës dhe e kujdesit ndaj studentit mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit. Departamenti përgjegjës për programin e studimit, cakton një pedagog përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e praktikës profesionale. Ky pedagog në bashkëpunim edhe me Zyrën e Këshillimit të Karrierës informon dhe mbikqyr studentët dhe realizon kërkesat e praktikës profesionale, sikurse janë të specifikuara në silabusin e praktikës.			
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë informacionin e duhur mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informohen nga zyrat përkatëse të kujdesit ndaj studentëve, sekretaria dhe kordinatoret përkatëse por edhe online nëpërmjet platformave UET LMS dhe Microsoft Teams. Gjithashtu një rol të rëndësishëm informativ ka edhe java e orientimit studentor që realizohet në fillim të çdo semestri.			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit gjendet në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit (UET LMS) dhe Web-site e Universitetit, dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët, jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distancë, nëpërmjet kompjuterit dhe smartphone.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

²³⁴ Të dhëna nga faqja zyrtare e Web (<https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/Turizem.pdf>) (Ref.Nr.47)

²³⁵ Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB (<https://uet.edu.al/new/aplikimet-dhe-pranimet/?lang=sq>) (Ref.Nr.47)

²³⁶ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Diplomë Profesionale Turizëm ²³⁷ . Nëpërmjet Zyrës së zhvillimit të karrierës dhe Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UET disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit Diplomë Profesionale Turizëm, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve ²³⁸ .
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve Diplomë Profesionale në Turizëm që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre duke mbajtur në sistem të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student lidhur me programin që ndjek ²³⁹ . Në lidhje me punësimin është Zyra për zhvillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni, që ndjekin studentët ²⁴⁰ .
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit (soft copy dhe hard copy) dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. IT dhe sekretaria nepermjet UMIS ²⁴¹ . Gjithashtu në proces ndihmon edhe sistemi UET-LMS.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të	Në UET hartohen raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve ²⁴² , si dhe punësimin e tyre, duke i reflektuar këto të dhëna me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

²³⁷ Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23), pjesë e Aneksëve të Raportit (Ref.Nr.29)

²³⁸ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21) Pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.27)

²³⁹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)

²⁴⁰ Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23), pjesë e Aneksëve të Raportit (Ref.Nr.29)

²⁴¹ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VI. Mbi sistemet e informacionit në funksion të procesit akademik faqe. 80-81 (Ref. Nr.46)

²⁴² Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21) Pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.27)

përmirësimin të këtyre treguesve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese ²⁴³ sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Studentët organizohen në Këshilli Studentor, në fokus grupet e vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, nëpërmjet vlerësimit online për pedagogun etj. Studentët përfshihen gjithashtu edhe në Senatin Akademik të UET, Dekanat, Këshillin e Etikës, dhe në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UET garanton përfshirje reale, konkrete, dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme të studentëve në vendimmarrje (Këshilli i Studentëve), këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, vlerësim për pedagogët që u japin mësim etj. Këto të dhëna mbahen nga Zyra e kujdesit për studentët. Sa i përket zgjedhjes së Këshillit të Studentëve përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve të Këshillit të Studentëve është Drejtuesi i Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit ²⁴⁴ .
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, institucioni mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit, ku gjatë simestrit, studentët kryejnë jo më shumë se 5 lëndë dhe simestrat janë të balancuar ndërmjet tyre. Të gjitha procedurat u informohen studentëve në formën më transparente të mundshme, dhe veprimi i tyre mbi bazën e këtyre procedurave nuk has në pengesa burokratike që nga kordinatoret e departamenteve, sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera që ndihmojnë studentët në UET. Gjithashtu UET ka procedura joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme ²⁴⁵ . Kështu në rregulloren e programit të studimit specifikohet si më poshtë: <i>(9. TRANSFERIMET 9.1 UET-i, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procedura e transferimit, nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi, rregullohet me</i>

²⁴³ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.III. Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET-it (Ref. Nr.56)

²⁴⁴ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.III. Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET-it (Ref. Nr.56)

²⁴⁵ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm pika 9, (Ref. Nr. 7)

	udhëzim të veçantë. 9.2 Studentëve të regjistruar në këtë program studimi mund t'u njihen kredite të fituara në programe të tjera studimi në fusha të njëjta ose të përafërta, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të transferimeve në UET, por edhe njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara siç mund të jenë njohuri të informatikës, ose edhe të gjuhës së huaj, apo njohuri të veprimtarive formuese të nivelit të pas shkollës së mesme të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit të studimit. 9.3 Në këtë program studimi mund të transferohen studentë nga programe të tjera të studimit me karakter profesional, në fushë të njëjtë ose të përafërt, vetëm në fillim të vitit akademik. 9.4 Studentët që kanë përfunduar studimet në një program tjetër studimi, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e krediteve të lëndëve të njëjta ose të ngjashme. 9.5 Studenti ka të drejtë të transferojë vetëm lëndë të vlerësuara me notë përfundimtare kaluese. Në rast njohjeje studenti bart notën me të cilën është vlerësuar në programin e mëparshëm të studimit. Nga kjo klauzolë përjashtohen studentët që transferojnë studimet brenda UET-it, të cilëve u njihet e drejta e riprovimit për lëndët në provimin e të cilave nuk janë paraqitur ose kur janë vlerësuar me notë jokaluase. 9.6 Studenti regjistrohet në vitin e dytë nëse i janë njohur jo më pak se 30 kredite. 9.7 Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit. 9.8 Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes i departamentit.) Kështu që gjatë semestrit, studentët kryejnë jo më shumë se 5 lëndë dhe simestrat janë të balancuar ndërmjet tyre.
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nëpërmjet angazhimit periodikisht në mbledhjet e hapura të departamentit, studentët kanë mundësinë të përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, nëpërmjet sugjerimeve të ndryshme që ata bëjnë herë pas here. Gjithashtu ata mund të japin mendimet online në çdo moment nëpërmjet UET LMS dhe Microsoft Teams, dhe duke komunikuar direkt me departamentin përkatës.
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës. Provimet janë të sekretuara, garantohet totalisht anonimiteti i studentit. Vlerësimet e rubrikave të tjera janë gjithashtu transparente dhe pas çdo vlerësimi studentët vihen në dijeni për pikët e tyre. Pas çdo provimi organizohen dhe kryhen seancat sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit²⁴⁶. Në rast ankimimi, përsëri procedurat janë transparente. 5.8 Kërkesa për rivlerësim 5.8.1 Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të

²⁴⁶ Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm. Pika 5.8, faqe. 5 (Ref. Nr. 7)

	parashatrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. 5.8.2 Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një Komision ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UET ka krijuar procedurë dhe njësi të posaçme ²⁴⁷ në funksion të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, si dhe gjithë procesin akademik. Këto informacione dhe dokumenta merren dhe gjenden në zyrën e sekretarisë dhe koordinatorëve, në UET LMS, në website-n e institucionit. Gjithashtu në fillim të secilit semester UET organizon javën e orientimit akademik dhe studentët pajisen në formë të ndryshme të shkruara dhe elektronike me të gjithë silabuset e lëndëve dhe informacionet e tjera. Një rol të veçantë luan Zyra e kujdesit ndaj studentit dhe Zyra e këshillimit të karrierës.
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UET ka një sistem të posaçëm për mirëpritje (zyra e pranimeve) informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin (Zyra e kujdesit ndaj studentëve, Zyra e zhvillimit të karrierës, Zyra e projekteve dhe partneriteteve) (këshilluesit akademik, sekretaria mësimore, kordinatorët e departamenteve, regjistruesit e lëndëve, etj) e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet zyrës së kujdesit ndaj studentëve, si edhe njësive të tjera, por edhe me anë të sistemit UET LMS dhe Microsoft Teams ku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet email-it, që shërben si një mjet tjetër për informim dhe këshillim nga individët dhe njësitë përgjegjëse.
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret	Në UET funksionon zyra për këshillimin e karrierës dhe (zyra për kujdesin ndaj studentit) të cila ofron në mënyrë të vazhduar dhe

²⁴⁷ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, D.I.1.3. Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim (Ref. Nr. 27.1)

studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	periodike informacion dhe orientim të posaçëm, këshillim të karrierës, informacion i lidhur me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera, si edhe orientim në lidhje me tregun e punës ²⁴⁸ .			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Zyra për këshillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit ²⁴⁹ dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse, dhe në kuadër të funksionit të saj ²⁵⁰ merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre, nëpërmjet kontakteve dhe bashkëpunimit me organizatat partnere të UET. Feedback-u në lidhje me këto çështje u kalohet në mënyrë të veçantë studentëve por edhe oraneve drejtuese të UET.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁴⁸ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

²⁴⁹ Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23), pjesë e Aneksëve të Raportit (Ref.Nr.29)

²⁵⁰ Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Diplomë Profesionale” në “Turizëm” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit “Diplomë Profesionale: Turizëm” është hartuar për t’u dhënë studentëve edukim cilësor. Ai është në përputhje me Misionin, Objektivat dhe Strategjinë për Zhvillim të Institucionit, ku UET synon të bëhet një lider në sistemin universitar shqiptar.
2. Gjatë hartimit të programit të studimit Departamenti është konsultuar me përfaqësues të tregut të punës dhe grupe ekspertësh. Bashkëpunimi i mëtijshëm në procesin e, rishikimit të syllabus-eve të lëndëve, zhvillimit të mësimdhënies si lektorë të ftuar, dhe realizimit të praktikave mësimore, sjell harmonizim të njohurive teorike me ato praktike, dhe bën që programi t’i përgjigjet më mirë kërkesave të tregut të punës, duke lehtësuar mundësitë për punësimin e studentëve.
3. Në UET zhvillohen studime mbi tregun e punës dhe punësimin, të mbështetura mbi marrëveshjet e lidhura me kompani dhe institucione të ndryshme, apo aktivitete të tjera të realizuara si: UET Open Days, Biznese të ftuar në auditor, takime me Alumni UET, takimet e Bordit të Tregut të Punës, etj.
4. Në UET ka struktura që ndjekin studentët pas diplomimit, duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e tyre, ecurinë e tyre në treg, si edhe zhvillimet dhe ndryshimet në tregun e punës, të cilat ua vendos në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese të UET.
5. Institucioni ka organizuar Panair Pune dhe Karriere, ku Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në të cilin bën pjesë programi i studimit, ofron për studentët mundësi kontakti për punësim, me rreth 50 kompani të njohura në fushën e biznesit.
6. Pedagogët në këtë program studimi kanë gradat dhe eksperiencën e duhur për të ofruar mësimdhënie bashkohore, ku synimi kryesor është garantimi i një procesi mësimor cilësor. Trajnimi i personelit akademik dhe njohja e tij me metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, është element kontribues në këtë drejtim.
7. Për shkak të Pandemisë Covid-19, procesi mësimor në UET zhvillohet nëpërmjet përdorimit të dy platformave online UET-LMS, dhe Microsoft TEAMS, të cilat kanë ndihmuar së tepërmi që procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të kryhet sa më normalisht. Nëpërmjet tyre, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët që ata zhvillojnë, dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit.
8. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program studimi, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line, ku Biblioteka e UET është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage&Ebsco dhe Questia, dy platforma të mëdha elektronike nga të cilat studentët mund të aksesojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj. Literatura e përdorur në këtë program studimi është bashkëkohore.
9. Sistemi i vlerësimit të performancës në UET është në funksion të cilësisë së mësimdhënies, dhe synon arritjen e objektivave dhe standarteve bashkohore. Ai është vlerësim i gjithëanëshëm dhe bazohet në treguesit e performancës së stafit akademik. Roli i KSBC në këtë drejtim është mjaft i rëndësishëm.
10. UET nxit përfshirjen e pedagogëve në mobilitete akademike dhe krijon mundësinë për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies, të përfituara prej shkëmbimit të eksperiencave me pedagogë të Universiteteve partnere jashtë vendit. Gjatë periudhës së zhvillimit të programit, ka pasur mobilitet të stafit të departamentit në universitete jashtë vendit.
11. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm, dhe zhvillimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik. Ai nxit: publikimin e artikujve, pjesëmarrjen në konferenca, projekte, mobilitete jashtë vendit, etj. Institucioni gjithashtu vendos në dispozicion të publikimeve Revistën Shkencore “Economicus” dhe Konferencën Ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”.

Pika të dobta

1. Prej Marsit 2020, efektiviteti i marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si edhe i aktiviteteve me specialistë e të ftuar nga fusha e biznesit, nuk ka qenë i duhuri, si rezultat i Pandemisë Covid-19.
2. UET mbështet partneritetet me organizata vendase dhe të huaja dhe promovon studentët për përfshirjen e tyre në projekte dhe mobilitete, por aktualisht nuk ka pasur përfshirje në projekte dhe mobilitete për studentet që ndjekin programin e studimit. Në këtë drejtim Pandemia ka qenë një faktor i rëndësishëm pengues.
3. Ndërprerja e zhvillimit të Provimeve të Ndërmjetme (për lëndët e tipologjisë T2) për shkak të Pandemisë Covid-19, dhe zhvillimi vetëm i një Provimi Përfundimtar, e rëndon peshën e vlerësimit të studentëve vetëm në fund të vitit, duke cënuar shpërndarjen e saj (peshës) gjatë gjithë vitit.
4. Për të rritur transparencën në procesin e korrigjimit të provimeve, është e nevojshme të përdoren edhe sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin subjektivizmin në vlerësim, thjeshtojnë procesin vlerësues dhe rrisin paanshmërinë (p.sh., përdorimi i sistemit Clean Score).
5. Pavarësisht nga puna e bërë, pasurimi i Bibliotekës së UET mbetet një ndër sfidat kryesore të këtij institucioni. Jo të gjitha lëndët kanë literaturën e fundit në gjuhën shqipe. Biblioteka ofron edhe leximin e librave online, por vetëm për literature në gjuhën angleze.
6. Pavarësisht nga puna e madhe që ka bërë UET në mbështetje të këtij programi studimi, ende numri i studentëve mbetet i vogël. UET duhet të mbështesë më shumë programin duke rritur infrastrukturën e përshtatshme për këtë program (software të caktuar, laboratorë special, etj).

Lista e dokumentacionit mbështetës të vetvlerësimit

Lista e mëposhtme është dokumentacion i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë; mundet që në një dokument mund të përmbliiden disa nga të dhënat e kërkuara.

Në rastet kur dokumenti është ndryshuar totalisht ose pjesërisht, citimi i tij duhet të reflektojë edhe ndryshimet e bëra (ose të bashkëngjiten të dy dokumentet). Gjithashtu mund të përdoren evidenca të tjera që Institucioni ka në funksionin e tij.

Lista e dokumentave përmban **emërtimin e plotë të dokumentit** (psh statuti etj), ndërsa në Raport duhen cituar **edhe pjesët përkatëse të tij (psh statuti i IAL, neni x, pika y).**

Në rastin e mbështetjes / citimit në ligjet/aktet ligjore, këto dokumenta duhet të jenë pjesë e listës së mëposhtme (pjesërisht/ose plotësisht)

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i IAL (Pjesë për kriteret përkatëse); (Pritet te vije dokumenti i fundit, kemi perdor modelin e vjeter)
3. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 (Strategjia e zhvillimit te Institucionit)
4. Plani strategjik 2015 – 2020 (Strategjia e zhvillimit te Institucionit)
5. Rregullore e Institucionit të AL;
 - 5.1 URDHER i Rektorit të UET, datë 23/03/2020, Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19
 - 5.2 Urdhëresë për vlerësimin e studentëve me aftësi shikimi të kufizuar.
 - 5.3 Vendimi Nr. 2, datë 04/05/2020, i Senatit Akademik të Universitetit European të Tiranës, mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19.
 - 5.4 Rregullore tranzitore Mbi Vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pandemisë COVID-19.
 - 5.5 Rregullore Tranzitore” Për Zhvillimin e Procesit Akademik Gjatë Vitit Akademik 2020-2021, Në Kushtet e Pandemise Covid-19”, nr.53_2 prot, datë 02.11.2020, Neni.5” Kontrolli dhe vleresimi i dijes”.
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit
7. Rregullore e programit të studimit DP – Turizëm.
 - 7.1 Objektivat e Programit te studimit.
 - 7.2 Dokumenti A. IV. Sistemi i vlerësimit te studenteve.
 - 7.3 Format i Tezës së Provimit Përfundimtar.
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshem te cilesise
9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore
10. Rregullore e diplomimit; (Rregullore e programit te studimit DP – Turizem, Neni 8. Diplomimi)

- 10.1 Kalendari Akademik 2018-2019
- 10.2 Kalendari Akademik 2019-2020
- 10.3 Kalendari Akademik 2020-2021
- 11. Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore
- 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.
 - 12.1 Panairi i Punës 2019, “Dita e Biznesit në UET”
 - 12.2 Plan-Projekt Alumni
 - 12.3 UET Alumni Business III/2019
 - 12.4 Relacion mbi Format me anë të të cilës Universiteti Europian i Tiranës zhvillon këshillimin e karrierës
- 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave
- 14. Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula
 - 14.1 Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm.
 - 14.2 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese.
- 15. Modeli i diplomës Diplomë Profesionale Turizëm
- 16. Vlerësimi përpara hapjes së programit
 - 16.1 Bordi i Tregut Të Punës 2017-2018, Departamenti Menaxhim Dhe Marketing
- 17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve;
 - 17.1 Bordi i Tregut Të Punës 2018-2019, Departamenti Menaxhim Dhe Marketing
 - 17.2 Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës, Proces-verbal mbledhje e Bordit te Tregut të Punës
 - 17.3 Universiteti 2030, Forumi i përvitëshëm me bordet e tregut të punës, i përbërë nga ish studentë të UET, për 11 departamente.
 - 17.4 Nisma UET – Universiteti i Biznesit
 - 17.5 Programi 250+, Programi 500+
 - 17.6 Tryezë konsultuese – Industria e turizmit dhe nevojat për BNJ (Innovation Lab)
- 18. Analiza e permbushjes se rekomandimeve te hapjes se programit (nuk ka patur rekomandime)
- 19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite;
 - 19.1 Silabusi i Praktikës Profesionale
 - 19.2 Format i Syllabusit Cikli i parë dhe dytë
- 20. CV e stafit akademik të programit të studimit
- 21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit). (Nuk ka)
- 22. CV e stafit ndihmës akademik (Nuk ka)
- 23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse

- 23.1 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit.
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit)
- 24.1 Kontratë model e punës për personelin e jashtëm akademik
- 24.2 Kontratë model e punës për personelin e brendshëm akademik
25. Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, të programit të studimit
26. Të dhëna Tabelore për numrin e programeve të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse.
27. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.
- 27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.
28. Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.
29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve,
30. Të dhëna tabelore për: njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë;
- 30.1 G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.
- 30.2 G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët
- 30.3 Plani Veprimi_KSBC
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane; (nuk kanë dale akte nenligjore të MASR lidhur me kodifikimin e programeve të studimit)
32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese.
- 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të mëtijshme, për studentët e diplomuar; (Nuk ka patur trajnime për studentët e diplomuar)
34. Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis UET dhe institucioneve të tjera
35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;
36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit; (nuk parashikohet për programet me karakter profesional)
37. Shpërndarja e raporteve të KSBC
- 37.1 Të dhëna për anëtarët e KSBC,
- 37.2 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC (Ref. 37.2)
38. Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësimit profesional;
39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.
40. Pyetësori i studentëve (dokumenti me nr. 30.2 në listën e dokumentave)
41. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik; (shiko dokumentin me nr. 30.3 në listën e dokumentave)

42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit
43. Kërkimi shkencor
 - 43.1 Dokumenti C.IV. Parimet e organizimit të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve.
 - 43.2 Raporti në lidhje me Mobilitetet i Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020
44. Formati i Dosjes personale të stafit (shiko dokumentin numer 44.1 dhe 44.2)
 - 44.1 Lista e dokumentacionit që përmban dosja individuale staf akademik me kohë të plotë
 - 44.2 Lista e dokumentacionit që përmban dosja individuale staf akademik me kohë të pjesëshme
45. Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit; (Shiko dokumentin numer 42, që përdoret për të mbështetur edhe përgjigjen e Kriterit 3, Standardi III.2 dhe Kriterin 2 Standardi IV.3.)
 - 45.1 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online
 - 45.2 E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë
 - 45.3 Shembull procedure_blerje literature
 - 45.4 Economicus 2018-2019
46. E.VI. Mbi sistemet e informacionit në funksion të procesit akademik.
 - 46.1 Trajnim mbi sistemin UET LMS.
 - 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun.
 - 46.3 UET LMS Guidë për studentët.
 - 46.4 Manual i përdoruesit të sistemit UMIS.
47. Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB www.uet.edu.al
48. Politikat institucionale të publikimit të informacionit (Udhëzues të posaçëm; takime të hapura; faqja e IAL në web; etj) (shiko dokumentin nr 47, që përdoret për të mbështetur edhe përgjigjen e Kriterit 1 dhe 2, Standardi IV.4.)
49. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; plani për mbështetje financiare për një cikël të plotë studimi; (Shiko dokumentin nr 50, që përdoret për të mbështetur edhe përgjigjen e Kriterit 5 dhe 6, Standardi IV.3.)
50. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit
51. Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparencë me publikun; (shiko dokumentin 27.1 dhe 47 që përdoren për të mbështetur edhe përgjigjen e Kriterit 1, 2 dhe 3, Standardi IV.4; Kriterin 3 e sidomos Kriterin 6 të Standardi V.1.)
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (nëse ka patur); (Nuk ka)
53. Ligje dhe akte nenligjore
54. Licensime dhe akreditime
55. Ditët e Studimeve Shqipëtare (DSSH) 2019-2020.

56. D.III. Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET-it

Dokumenta te tjera te perdorura:

1. *Aktivitetet e organizuara në kuadër të programit të studimit*
2. *Procesverbal i Mbajtjes së Mbledhjes me Studentët*
3. *Mbledhje e hapur departamenti me studentet Bachelor dhe DP. (Procesverbale)*

***** 31 MAJ 2021